

Kuvendi

Qarku LEZHE

Arbjan Mazniku:

Vijojmë mbledhjen e komisionit, ëë, pas një pushimi të shkurtër, ëë, me tani kryetarët e bashkive të Qarkut të Lezhës, ëë, kryetari i bashkisë së Lezhës, ëë, për arsye objektive pune, nuk ka mundur të jetë, ëë, siç dhe kemi thënë do t'i lejmë mundësinë kryetarëve që kanë pasur, s'kanë pasur mundësi të jenë në një mbledhje të posaçme në fund. Kemi, ëë, zonjën Cara, kryetarja e bashkisë së Kurbinit, edhe zotin Blyshi, ëë, kryetari i bashkisë së Mirëditës. Unë mendoj që meqenëse kemi bërë parashtrimin gjatë ditës, fillojmë direkt me pyetjet, ëë, nëse biem dakord edhe kushdo që ka pyetje.

Luçiano Boçi:

Po dakord me pyetjet. Vazhdojmë direkt.

Ermal Elezi:

Ëë, ne kemi pasur disa diskutime. Unë do të doja te ajo që është tema që diskutohet më shumë dhe ju mbase keni dhe opinionet e qytetarëve në lidhje me këtë çështje. Përsa i përket aspektit territorial, si i shihni bashkitë e juaja, qoftë nga pikëpamja e territorit që menaxhoni aktualisht dhe çfarë sfidash keni? Nëse vlerësoni që duhet të ketë një rifragmentim territorial në bashkitë e juaja, që do të thotë bashkitë të, ëë, ndahen apo të bëhen disa njësi vendore brenda bashkisë, dhe po në këtë këndvështrim, ëë, keni shtatë njësi administrative në Mirëditë dhe katër në Kurbini. Ëë, është e udhës dhe a keni ndonjë, ëë, qoftë idetë tuaja apo studim fjalë e gjerë, po ndonjë vlerësim nëse këto njësi administrative duhen rishikuar qoftë duke e shtuar numrin apo duke e pakësuar numrin? Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Ëë, zonja Cara dhe zonja Blyshi, ëë, kemi vendosur një rregull që tentojmë që t'i mbajmë përgjigjet deri në tre minuta, do ishte ideale. Po, sigurisht nuk është një rregull i fortë, por është thjesht për të koordinuar procesin. Faleminderit.

Majlinda Cara:

Mirë, faleminderit të nderuar bashkëkryetarë të komisionit të posaçëm, të nderuar deputetë, faleminderit sot për realizimin e kësaj dëgjese me kryetarët e bashkive. Më lejoni që personalisht t'i përgjigjem pyetjes së zotit deputet, por në opinionin tonë personal dhe në opinionin tim përse i përket reformës territoriale edhe reformës së 2014-s, dhe përse i përket bashkisë së Kurbinit, nuk besoj se ka nevojë për rishikim territorial, për copëtim apo edhe për shtim, sepse vetë Kurbini që në '92-in që u nda nga rrethi i Kruaj, Krui, edhe për nga vetë natyra është i kufizuar nga dy lumenjt, pra edhe kufiti ia ka dhënë edhe natyra, kufizohet nga dy lumenjt, nga Lumi i Madh në veri dhe Droj në jug, dhe nga mali i Skënderbeut me Krujën dhe me Burrelin. Kështu që nuk besoj, por dhe opinionin i qytetarëve të mi, nga takimet e shpeshta apo dëgjuesat, nuk besoj që ka nevojë për copëtim apo shtim të territorit të bashkisë së Kurbinit.

Për sa i përket njësive administrative, duke qenë se bashkia Kurbin është e organizuar në katër njësi administrative, kryesisht Laç, Mamurras, Fushkuqe dhe Milot, duke qenë që edhe sapo e thashë nga natyra këta njësi administrative kanë edhe një afërsi gjeografike njëra me tjetrën, mund të jem e mendimit që duke adresuar dhe këtij komisioni që mund të shihet në reformën e ardhshme një shtim kompetencave të administratorëve apo të gjithë njësisë administrative, por e mendimit që nuk ka nevojë për shtim apo për copëzim të tyre.

Arbjan Mazniku:

Zoti Melyshi.

Albert Melyshi:

Përshëndetje të nderuar deputet. Ëë, faleminderit për mundësinë, faleminderit për mundësinë për të diskutuar dhe për të ngritur disa nga problemet, po themi, kryesore që bashkitë kryesisht kanë në territorin e tyre. E sa i përket bashkisë së Mirëditë, Mirëdita në fakt ka një veçori të ndryshe nga bashkitë e tjera në edhe në aspektin historik të saj, dhe nëse do më duhet të normalisht do përcjell edhe atë çka diskutojmë në përditshmëri me qytetarët, por edhe takimet të ndryshme që kemi zhvilluar pikërisht edhe për të marrë feedback-un e tyre për ndarjen territoriale, ka një diskutim në masë të gjerë dhe një kërkesë drejtuar këtij komisioni pikërisht për kufijtë etnografikë dhe kufijtë, ëë, e vjetër historik të vetë Mirëditës. Nëse nuk e di ndonjëri do ketë lexuar rreth historisë konkrete të Mirëditës dhe kufijve të tyre dhe asaj që janë prekur në histori, Mirëdita ka pasur një sipërfaqe afërsisht 1700 km², gjë që sot, ëë, kjo bëhet fjalë në vitin 1949, gjë që sot është afërsisht 867 km². Në gjithë këtë territor normalisht që nuk shkojmë tek logjika e kërkesës të afrimit të gjithë këtyre kufijve, nëse nuk ka një ndarje konkrete edhe të financave ose një diskutim real të këtij komisioni dhe një vendimmarrje që fuqizimi i bashkive të shkojë në respekt edhe në koherencë edhe me territorin. Pra, Mirëdita ka konkretisht një kërkesë pothuajse unanime për të shkuar në kufijtë historikë të saj, ëë, gjë e cila në fakt është shprehur edhe në takimin që komisioni ka patur në Lezhë, në Qarkun Lezhë, dhe kjo do duhet të diskutohet dhe patjetër që të dëgjohet dhe të merret edhe mendimi, mendoj unë, edhe i qytetarëve që, ëë, kjo është në masë, në kuptimin e kërkesës së tyre drejtuar këtij komisioni. Sa i përket njësive administrative.

Albert Melyshi:

Si bashki, pastaj jam krejt i hapur për të diskutuar dhe duhet të jemi atëherë edhe po, pikërisht, pra që duhet të shkojë Mirëdita në kufijtë etnikë të saj, në kufijtë territorial, sepse në vitin 1949 ajo që përmenda është se janë shkëputur, janë shkëputur një pjesë e territoreve të saj. Ëë, këto mund të diskutohet pastaj dhe të shihen më i mira se si mund t'u shërbejë qytetarëve, patjetër edhe me shtimin e bashkive. Pra, nuk është, nuk është të thënë që duhet të ketë një bashki Mirëditë edhe quhet bashkia Mirëditë, po mund të jetë edhe bashkia Rupik. Është një, sërish, një qytet, ka qenë një bashki, e cila po çojmë sot bashkitë.

Ermal Elezi:

Po me, me situatën aktuale, nëse nuk shtohet territori, ju mendoni që duhet të shtohen këto bashki brenda bashkisë aktuale Mirëditë?

Albert Melyshi:

Po patjetër. Nëse shtohet territori, mund të shtohen edhe bashkitë.

Ermal Elezi:

Jo, jo, pa u shtyllë territori. Me aktualen që keni si bashki Mirëditë, mendoni që duhet rifragmentuar territori i bashkisë tuaj në bashki më të vogla?

Albert Melyshi:

Po. Pra, nëse, nëse do shkonim, nëse do shkonim tek diskutimi që, ëë, zgjerimi i territorit do shkonte edhe me, me shtimin e bashkive, do ishte, do ishte pa, pa zgjerim, do duhet të diskutojmë pastaj mbi financat vendore. Sepse, ëë, shtimi i territorit me këto financa që sot ka bashkia, patjetër që kufizon edhe shërbimet e qytetarëve. Për të shkuar tek njësitë administrative, ëë, Mirëdita ka shtatë njësi administrative që në fakt, në raport me vitin 2015 ose 2016, në kohën kur, o 2014 ndjesë, kur është bërë dhe ndarja territoriale, ëë, Mirëdita e gjitha, ose po themi ajo që sot është bashkia Mirëditë, kishte pesë komuna dhe dy bashki. Sot janë të shpërndara në shtatë njësi administrative. Unë kam bërë një analizë të timen në raport me njësitë administrative edhe me lëvizjen demografike të popullsisë nga shkrija e komunave dhe bashkive në gjendjen e popullsisë atëherë dhe në gjendjen e popullsisë sot. Realisht, ulja nga komuna në njësi administrative heqja shumë kompetencave këtyre njësive administrative, respektivisht ka çuar pastaj edhe në uljen e numrit të popullsisë në këto, në këto njësi administrative. Do ishte, ëë, e udhës dhe e besoj dhe e logjikshme që ajo bashkohem në të njëjtin mendim me kryetaren që njësitë administrative duhet të kenë, ëë, më shumë kompetenca dhe një rol më të fortë në, në, në territor. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Po të lutem, zoti Mziu.

Xhelal Mziu:

Faleminderit. Ëë, në fakt po bëhet si e përhershme në këto takime që bëjmë në rrugë në Qarkull. Si zakonisht, ëë, kryetari i bashkisë së qendrës së Qarkut nuk vjen, siç ishte edhe rasti i Gjirokastrës pak më përpara. E njëjta gjë ndodh edhe tani. Nuk besoj që mund të ketë angazhime më të mëdha sesa për një çështje të rëndësishme që ka të bëjë me qytetarët. Së dyti, ne sot kemi, ëë, Qarkun e Gjirokastrës e Lezhës, që sapo mbaruam me Qarkun e Gjirokastrës, dhe janë dy qarqet më ekstreme. Kemi Qarkun e Gjirokastrës që kishte shtatë njësi, dhe në këndvështrimin tim është shumë më efiçente, sepse, ëë, është bërë e decentralizuar qendrat urbane në Qarkun e Gjirokastrës, duke patur shtatë, ëë, njësi vendore. Ndërkohë, Qarku i Lezhës, që ka një popullsi më shumë sesa dy herë më shumë apo 2.2 herë më shumë sesa Qarku i Gjirokastrës, ka vetëm tre bashki. Dhe për ta treguar që ka qenë e padrejtë, po themi, ndarja territoriale e 2014-s, por jo vetëm e padrejtë, por nganjëherë më shkon mendja mos është bërë dhe thjesht pse është në zonën e veriut. Sepse unë po jap disa fakte për të treguar që brenda këtij qarku ne kemi patur bashki. Kanë qenë 65 bashki deri në vitin 2015 dhe kanë qenë 308 komuna. Dhe në 65 bashkitë që janë prodhuar gjatë dhe një bashkie, nga të cilat këto gjatë dhe një bashkie po muara vetëm rastin e Gjirokastrës, janë disa komuna të vetme që janë kthyer në bashki. Ndërsa në Qarkun e Lezhës kemi bashkinë e Shëngjinit që nuk është më bashki. Kemi bashkinë e Rubikut që nuk është më bashki. Kemi bashkinë e, ëë, Laçit që nuk është më bashki. Kemi, ëë, qytezën e Milotit që nuk është më bashki. Pra, nuk është se nuk ka patur zona urbane, po ka patur një qasje totalisht ekstreme, ku të dyja këto bashki mjafton po

të bëjësh krahasimin e tyre sesa, ëë, e padrejtë ka qenë ajo ndarje. Besoj që dhe dy kryetarët përfaqësues janë, janë absolutisht, ëë, të mendimit që decentralizimi është parësor për t'i shkuar sa më afër qytetarit, se financat janë parësore për të patur sa më shumë para në shërbim të tyre, se pavarësia është një tjetër element shumë i rëndësishëm për të, për të qenë kompetent në territorin e tyre. Të treja këto kanë munguar dhe absolutisht jam i bindur që, ëë, nuk mundet ta refuzojmë, bie fjala, që të jetë Rubiku, që ka qenë një ndër bashkitë, ëë, mjaft efiçente dhe bashkëpunuese me faktorin ndërkombëtar. Nuk mundet të lihet mënjani Shëngjini apo Miloti apo, ëë, Laçi apo dhe, dhe të tjera të cilët janë, janë propozuar nga disa qytetarë. Tjetër, dhe unë do të doja qëndrimin e tyre. A do ishin dakord pa parë, po themi, atë as interesin politik as personal, por thjesht në raport me qytetarin që të kishim këto bashki që të ishin më afër qytetarëve, edhe duke qenë koherente me, ëë, mesatarën e vendeve të Bashkimit Evropian. Së dyti, a, ëë, a është normale që është rritur, po themi, fondi i pagave në të treja bashkitë që drejtohen? Janë rritur tre deri në katër herë fondi i pagave në raport me 2015-ën, dhe në vend që paratë të shkojnë për investime dhe shërbime ndaj qytetarëve, shkojnë në fakt për persona të cilët nuk kanë një vend pune, nuk kanë një karriker, nuk kanë një kompjuter, nuk kanë një zyrë, nuk kanë asnjë vegël pune, ato që punojnë në terren. Dhe jo më kot Shqipëria ka rentabilitetin më të ulët të fuqisë punëtore, nja dy herë më pak sesa rajoni, nja katër herë më pak sesa mesatarja e vendeve të Bashkimit Evropian, dhe kjo është shqetësuese. Pra, nuk u arrit kauza kryesore e kursimit, ekonomisë së shkallës, por përkundrazi paratë shkuan në destinacion tjetër, dhe mjafton dy shifra: 2024-a, se 25-tën akoma s'e ka nxjerrë qeveria, po krahasoj 2024-ën me 2015-ën, dhe kemi absolutisht një ndryshim total: 50% më pak investime, dhe ndërkohë, ëë, kemi më shumë sesa 30% e më shumë është rritur fondi i pagave, ose thënë ndryshe, është rritur në 20% të totalit, shkojnë më shumë ekstra për paga dhe sigurime shoqërore. A nuk do të ishte normale që të kufizohej numri i administratës, sepse jemi rekord, rekord në pushtetin qendror, rekord në pushtetin vendor, dhe absolutisht nuk besoj që ka një kryetar. Unë kam qenë dhe vetë kryetar dhe mjaft kolegë, ëë, çdo kryetar dëshiron që të, ëë, ta konkretizojë në investime dhe në shërbime, dhe jo në numër punonjësish. Një tjetër element shoh, po marr rastin e Mirëditës. Mbjaj mend një radhë në një intervistë, po dëgjoja, ëë, kryetarin zotin Miliushi që po fliste për rentën minerale. Në mos gaboj, ëë, e kam dëgjuar thjesht në një radio që ju thoni që këshilloni 1 milion e 200 mijë lekë të vjetra, nëse nuk e kam marrë, nëse jam koherent, nëse është ashtu, ma thuaj. Si mundet një bashki që është një ndër bashkitë, ëë, nuk po them e para siç është Bulqiza, por është një ndër bashkitë të cilat ka, ëë, rentë minerale të jashtëzakonshme, që i ka, i ka dhënë buxhetit të shtetit pafundësisht, dhe 1.2 milion lekë të vjetra, ose 120 mijë lekë, të marrësh rentë minerale, kjo është qesharake. Ndërkohë, një bashki, po themi, bregdetit, nëse ka 1 m² rërë, merr më shumë sesa renta minerale që merr bashkia e Mirëditës, po njëherazi dhe bashkia e Bulqizës, apo e Klosit, apo e Burrelit, apo e Kuksit, apo e Tropojës, apo e Këlcyrës, apo kush do të qoftë ajo, ku ka, ëë, rentë minerale, por edhe përtej rentës minerale, edhe kur tokat e tyre janë zënë, bie fjala, nga liqenet, siç është Ulza, apo siç është hidrocentralet, dhe ndërkohë ja ka pamjaftueshmëria ka ardhur edhe për shkak të zënies së këtyre resurseve. Dhe ndërkohë ne nuk kemi si vendet e tjera që të marrim atë taksën e pasurisë. Nëse toka shfrytëzohet, ëë, dhe të ardhurat nuk shkojnë tek qytetarët e asaj zone, si mundet, po themi, të mbijetojë nëse, ëë, renta minerale apo taksat e tjera nuk shkojnë? Absolutisht që nuk e mundëson. Pra, po prapë pyetja ime: a jeni të kënaqur me këtë rentë simbolike dhe nuk po merrni me informalitetin? Që bie fjala, nxjerrin 100 tonë, po e konkretizoj, dhe në fakt shkruan 10, e kur bien për t'i marrë, po themi, bashkia është me një presje, nja 60 pas presjes dhjetore për të shkuar tek përfitimi i atyre qytetarëve. Tjetër, vazhdojnë që të kemi 1% fond të pakuruar ose grant të pakuruar që jepet në fillim të vitit me 1%. Çfarë mund të bëjë, po themi, me 1%? Po marr, po prapë, këtë qark ose këto tre bashki, kur ikin popullsia,

zvoglohet numri i tyre, jepet mbi bazën e numrit të popullsisë, dhe ndërkohë sipërfaqja, po ajo është, rrugët, po ato duhen, ujësjellësa, po atë, ajo kapacitet duhet. A jeni të kënaqur me këtë 1%? Ndërkohë që vendet e tjera të rajonit e kanë dy apo tre herë më shumë. Grante, nuk e di, a merrni grante konkurruese, apo vjen i bën Fondi Shqiptar i Zhvillimit? Nuk e di nëse si është situata në dy bashki që ju drejtoni. Delegimi i kompetencave se është bërë me bujë të madhe, u deleguan shtatë kompetenca, dhe në fakt, në këndvështrimin tim, sepse e kam qenë dhe vetë në ato, në atë mandat katërvjeçar, delegim kompetencash, pamjaftueshmëri fondi pagash për to, dhe nuk po merren me shpenzimet e tjera që duhen. Dhe ky është një tjetër shqetësim, dhe kontributi juaj në këtë drejtim duhet t'i vlejë komisionit dhe produktit final, për ta afruar me rritjen e numrit të bashkive, për t'i rritur, po themi, potencialin ekonomik nëpërmjet rritjes së grantit, por në ndërkohë për t'i dhënë dhe kompetencat tjera. Kush është kompetenca juaj? A mund të më thoni ju çfarë kompetence keni mbi pronën në bashkinë tuaj? Keni kompetencë? Nëse ju do të ndërtoni një shkollë, apo një qendër shëndetësore, apo një treg, ju duhet t'i drejtoni ministrisë. Ju nuk jeni si kudo në botë që pronari është pushteti vendor. Nuk e keni. A e keni ju zyrat e kadastrës aty? A e keni ju zyrat arsimore aty? A keni rol ju te shërbimi parësor? A keni rol ju tek arsimit? Si në Kosovë, arsimit parauniversitar ka kompetenca drejtpërdrejtë, po themi, pushteti vendor, dhe normalisht nuk krijon ato problematikat që po të shkosh në zonat rurale, ke shkolla pa gjama, pa dyer, pa dritare, sepse nuk ka kapacitet. Jo se nuk do një kryetar bashkie, po ato janë kapacitetet. Dhe besoj që askush prej jush dysh, po dhe të tjerë, nuk ndihet rehat kur sa më shumë periferisht të shkosh, nuk ka rrugë të asfaltuara, ka shkolla të rrënuara, ka qendra shëndetësore që nuk plotësojnë kapacitetet, e për pasojë krijojnë premisat që ato të largohen, nuk punohet bujqësia. Por më thuaj një bashki se si mund të jetë e suksesshme kur bujqësia nuk punohet, blegtori nuk ka, sepse nuk ka rol fare pushteti vendor. Dhe duhet të jetë alarmante kjo situatë për të mos shkuar përtej kësaj. Nuk mund të krahasosh bashkinë e Mirëditës me bashkinë e Lezhës, sepse Lezha ka një vijë bregdetare me kilometra të tërë që i sjell të ardhura pafundësisht. Ndërsa si mundet, po themi, të ketë të njëjtën mesatare të ardhurash bashkia e Mirëditës, apo qoftë edhe bashkia e Kurbinit? Kështu që dhe në këtë ka një zgjidhje. Jepet një fond balancimi. Mesatrizohen të ardhurat për frymë nga të ardhurat vendore në rang shqipërie, dhe të gjitha ato bashki të cilat janë poshtë nivelit mesatar, delegohen në fund të vitit, pjesa e munguar, me një kusht që bashkia të ketë zbatuar pagesën fiskale. Dhe ju duhet të jeni po prapë të ditur që ka bashki që nuk e zbatojnë pagesën fiskale, se i mjaftojnë letrat e ndërtimit, po marr rastin Tirana, apo Durrësi, apo Thiri, të cilët në mbledhshmërinë e të ardhurave janë në nivelet më të ulëta, sepse ju mjaftojnë të ardhurat e tjera që vijnë nga ndërtimi. Kurse ku ka ndërtime në Mirëditë? Ku ka ndërtime në Laç? Pra, ajo çfarë unë do të sugjeroj, nja dhe për kolegët, por dhe për ju, që taksa balancimi për të mos patur këtë lloj situatë diskriminuese është zgjidhje, dhe ne s'kemi nevojë të bëjmë asnjë shpikje, mjaftojnë të zbatojmë një nga praktikatat që zbaton çdo vend anëtar i Bashkimit Evropian. Dëgjova një ditë një ekspert të majtë që doli në televizor dhe thonte: "Është rritur administrata publike, se janë rritur investimet." Kjo është një gënjeshtër. Një gënjeshtër. Investimet kanë qenë 36.5%. Sfidoj mazhorancën. 36.5% në vitin 2015 të buxhetit total të 373 njësisve vendore shkonin për investime kapitale. Në 2024-n që është mbyllur, vetëm 18%. Dhe ç'lidhje ka nëse rriten investimet, do rrisësh administratën, janë punëtorë, krahu ato? Kur rriten investimet, maksimumi që mund të bësh, nëse e bën me kapacitetet e burimeve njerëzore të urbanistikës, shto numrin e personelit, nuk do mbash, po themi, gjashtë inxhinierë, do bësh dhjetë. Po që të shtosh administratën nga 17 mijë në dyzet e sa mijë, dhe të thuash që janë rritur investimet, kur në fakt investimet janë përgjithësuara, më duket pak qesharake. Kështu që edhe në këtë kontekst, ju se thuhet po prapë që nuk ka kapacitete, bashkitë e vogla, apo sot është zgjidhur, dhe kur nuk ka kapacitete, projektet bëhen me

tender. Janë kompanitë të cilat e bëjnë. Por ajo çfarë ju mungon juve, ju mungon paraja. Dhe ngelen, po themi, të dorës së dytë, dhe nuk po merrem pastaj me ca çështje të tjera të cilat i kam ezauruar me të tjerët, por do të dëshiroja një opinion tuaj në lidhje me këto çështje të cilat unë ngrita. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit! Kryetarët, zonja Cara!

Majlinda Cara:

Ndjesë! Nëse nuk përgjigjemi me radhë, sepse ishin shumë pyetje në fakt në një moment, do të flas për bashkinë Kurbin dhe për.

Arbjan Mazniku:

Ndjesë, zonja Cara, thjesht një qartësim teknik. Ne nga zbardhjet që bëjmë në të gjitha degjesat, jo në këtë, nëse ka pyetje të cilat mbesin pa përgjigje, ose ka pyetje që ju mendoni do ja çojmë një kopje të zbardhur të pyetjeve që keni pa përgjigje, dhe kur janë çështje teknike që s'keni informacion, do e presim që na i përgjigjeni me shkrim në vijimësi. Por sidoqoftë, vijoni përgjigjen të gjithë pyetjeve që bëri zoti Mziu.

Majlinda Cara:

Përsa i përket bashkisë Kurbin, dhe duhet të them që si bashki pas reformës të vitit 2014, si bashki e madhe tashmë, bashkia Kurbin, sepse siç e thashë, ka qenë në katër, në dy bashki dhe dy komuna, në opinionin tim është ka pasur rezultat të suksesshëm, dhe këtë nuk e mbështes në opinion personal, por edhe në fakte, në atë çfarë është realizuar në bashkinë Kurbin, kundrejt investimeve ndaj nga viti 2014, kundrejt shërbimeve ndaj qytetarëve, ku këto shërbime përfshihen infrastrukturë, shkolla, kopshte, çerdhe, shëndetësi, furnizim me ujë të pijshëm, infrastrukturë, dhe duke parë ndryshimet e mëdha që ka në këto fusha, mund të them mendimin tim është që ka qenë një sukses i madhësisë së bashkisë së Kurbin. Patjetër që ka vend për përmirësim, sepse të gjithë e dimë që ka vend për përmirësim, dhe kryesisht në zonë natyrale për infrastrukturë, por që ne i shërbejmë çdo qytetari pa dallim nga zonat urbane. Dhe duke parë ndryshimet pozitive që ka pësuar bashkia Kurbin nga këto rezultate, duke e marrë edhe nga buxhetet, edhe nga buxheti i vetë, nga mbledhja e të ardhurave, patjetër edhe nga granti, patjetër edhe nga transfertat specifike që i kanë ardhur buxhetit të bashkisë, por nuk e lidh dot me atë që bashkitë, patjetër që kemi një fond që e dërgojmë për fond pagash, por rritja e numrit të punonjësve nuk ka ardhur për shkak të shtimit tonë të punonjësve, por ka ardhur edhe për shkak të disa funksioneve të deleguara që kanë ardhur. Që po të shohim bashkinë Kurbin në lidhje me administratat nga viti 2014 në raport me komunat, është po në të njëjtin nivel, por nga funksionet e deleguara dhe nga disa shërbime të tjera që janë shtuar në bashkinë Kurbin për t'i ardhur sa më pranë qytetarëve, patjetër që ka dashur një shtim personal. Ne duke marrë arsimin parauniversitar, ju e thatë që a kemi, patjetër ky është një funksion që na është deleguar edhe na është dhënë pa financa. Patjetër që ne kemi dhe vështirësitë në mirëmbajtjen e tyre. Rrugët rurale po ashtu, pyje, kullota, sistemi i zjarrfikës, të gjithë janë këto kompetenca të deleguara pas 2014-s, dhe patjetër bashkitë e vogla si ne gjenden para vështirësive financiare kundrejt përballimit të këtyre. Por duke parë që ju hasët pak këtë rentën minerare, besoj që këtu jam edhe ne nga takimet me kryetarë bashkish apo diskutimet që bëjmë, patjetër që në zonat tona, dhe kryesisht Kurbin dhe Mirëdita, ku edhe kanë shfrytëzimet e baseneve, mendoj që kjo rentë duhet

të na vijë pak më e madhe kundrejt bashkisë për të pasur edhe shërbimin më të mirë ndaj atyre qytetarëve që preken nga këto. Ndërsa për sa i përket shërbimeve në arsimin parauniversitar apo shëndetësor në Kurbin, tashmë po të them që këto vitet e fundit ka pasur investime të jashtëzakonshme në infrastrukturën e këtyre institucioneve, sa po të marrësh 30 vite së bashku. Ndërsa për sa i përket pronës dhe kadastrës, ne tashmë kemi një marrëveshje me ASHK-në. Ne kemi zyrat tona të, ne kemi zyrat që i shërbejmë qytetarëve për pjesën e kadastrës. Patjetër që për mendimin tim, nëse kadastra duhet të ishte pranë bashkive, mendoj që shërbimi duhet të ishte më efikas ndaj qytetarëve. Nëse kam harruar ndonjë pyetje nga këto?

Xhelal Mziu:

Edhe një pyetje, jo pyetje, po e tjetërsuat pyetjen në lidhje me arsimin dhe me shëndetësinë. Unë nuk pyeta sa investime. Unë pyeta sepse mirëmbajtja e tyre e arsimit, etj., është kompetencë e bashkive, dhe thashë kemi mjaftueshëm, sepse jam absolutisht i bindur. Përveç qendrave të bashkive, po të dalësh në periferi, ke shkolla pa dyer, pa dritare, pa rrethim, pa kushte minimale, dhe nëse do kishte ndonjë strukturë që e bën të mundur që ato të jenë koherente dhe me standard, janë bashkitë. Dhe ju thatë që është rritur investimet. Nuk pyeta se sa investime mund të kenë ardhur, po themi nga shkollat e Tërmetit apo të tjera. Unë po them standarti në shkolla dhe në qendra shëndetësore në të gjithë territorin absolutisht lënë për dëshiruar sa më larg qendrës së bashkisë, sepse nuk keni, nuk keni financime. Po, për ju, shqipërisht, dhe pak më përpara e thashë, ne marrim mbështetje financiare, kur themi ne, Shqipëria, pra pushteti vendor, merr dy herë më pak sesa Kosova, Maqedonia, dhe shumë herë më pak sesa vendet e tjera të rajonit. Pra, po të kishte mbështetje financiare për këto kompetenca të deleguara, nuk do të kishim, po themi, atë standard tek shkollat, tek qendrat shëndetësore, apo tek pyjet, apo tek bordi, tek kullimet, apo tek vaditja, apo mjaft delegim kompetencash të cilët ju ju ka vendosur në kushte jonormale, apo qoftë edhe tek zjarrfikësit që do detyroni të blini mjete, apo të shtoni personel, dhe paratë e qytetarëve, në vend që të shkojnë tek ato, do detyrohen për të shkuar tek këto kompetenca të deleguara, po pamjaftueshmërisht të mbështetura me financa nga pushteti qendror.

Majlinda Cara:

Besoj se e thashë në fjalën time pak më parë. Ëh, nuk e anashkalova pyetjen dhe thashë janë të pamjaftueshme këto funksione të deleguara, të shoqëruara me buxhet, por falë dhe këtyre investimeve të viteve të fundit, tashmë në bashkinë Kurbin janë investuar shkolla, kopshte dhe në shërbimin shëndetësor, si në fshat, si në qytet, dhe këtë ta jap me kompetencë plotë, patjetër që nevojitet për mirëmbajtjen e tyre në vitet në vazhdim që duhet të shoqërohet edhe me fonde. Pra, janë kompetenca të deleguara, por të pashoqëruara plotësisht me fonde, dhe vështirësitë tona janë. Zoti Mbyllshi, përgjigjet për zotin Mziu.

Albert Melyshi:

Atëherë, duke qenë se biem dakord të gjithë që pushteti vendor, duke qenë që biem dakord të gjithë që pushteti vendor është pushteti më afër qytetarëve, dhe kryetarët e bashkive janë aty çdo ditë me ta, patjetër që prekim në përditshmëri shqetësimet nga më të ndryshmet, dhe këtu edhe në lidhje me kompetencat e kryetarëve të bashkive apo të bashkisë në tërësi. Ëh, në fakt, në mendimin tim, ëh, zbehja e rolit të kryetarit të bashkisë ë po tregon që që dita e ditës, në fakt, bashki të cilat kryesisht financiarisht varen nga pushteti qendror, dhe që po themi, edhe pjesa e asaj që i delegohet bashkive është e

pamjaftueshme në atë grandin e përvitshëm, ëh, shpesh mendojmë që sidomos bashkisë së Mirëditës, mund të përmend shumë bashki: Fusharzi, Puka, Bulqiza, ë Kukësi, etj., etj., me radhë, që janë bashki absolutisht ë financiarisht të varur totalisht nga qeveria. Ëh, dhe aq më tepër që shumë sektorë në territorin tonë, qoftë arsimit, shëndetësia, ë elektriku, po themi, pjesa e shpërndarjes së energjisë elektrike, ujësjellësit, të gjithë këto janë kompetenca të cilat në fakt i janë hequr bashkive, dhe shpesh në diskutime me, të lutem, dhe shpesh janë diskutime që ë aq më tepër kur diskutojmë mbi bashki të cilat, mbi bashki të cilat, po themi, si e Mirëditës, që prodhon ë nuk e di me saktësi në përqindje, por mbi 15% të nevojave kombëtare energji elektrike, dhe ë po themi, linjat elektrike janë në një gjendje jashtëzakonisht të mjerueshme, sidomos në fshatrat kryesorë të Mirëditës. Kjo është shqetësuese dhe që realisht duhet parë në mënyrën se si kompetencat e bashkisë, apo qoftë edhe financat, të cilat qeveria shqiptare, arka e shtetit shqiptar, mbushet nga këto, nga këto sektorë, apo nga prodhimi i energjisë elektrike në këto territore, duhet të jetë ndryshe mënyra edhe e grandit të shpërndarjes në këto bashki. Dhe shpesh përballë qytetarëve, në lidhje me këto lloj shërbimesh, ne ë përveçse në kuptimin e kompetencave apo ndërhyrjeve që mund të bëjmë shpesh me drejtorët, qoftë të arsimit, qoftë të shëndetësisë, apo të shpërndarjes së energjisë elektrike, që janë kompetenca drejtpërdrejtë të qeverisë, por që bashkia, përballë ankesave të vazhdueshme të qytetarëve, shpesh është e pamundur që të ndërhyjë për të zgjidhur, për të ngritur shqetësimin e qytetarëve. Lidhur pastaj edhe me me grandin që unë mendoj që është një ndër ndarjet më të pabarabarta që mund të ketë në kuptimin financiar, në qoftë se nuk përllogaritet. Realisht në një farë mënyre edhe mbi prodhimin e saktë të atyre të ardhurave që sjell që sjell bashkia, apo territori i bashkisë për arkën e shtetit. Që do të thotë, kur marrim parasysh këtu që shpesh politikisht ka ndodhur në këto 35 vite, po ndodh sistematikisht tani që bashkitë djathta diskriminohen në kuptimin e investimeve. Unë kam tre vite kryetar bashkie. Kam mbi 30-40 projekte që i kam paraqitur. Në fakt, i pari që kam marrë është para tre ditësh i një kanali i vaditës, që është qesharak në raport me atë që janë kërkesa dhe nevojat e qytetarëve. Dhe aq më tepër që tashmë edhe grandit është minimalist në raport me kërkesat, apo shpesh mund të flas edhe ato investime që kanë ndodhur përpara se sa të isha kryetar bashkie, që shpesh kryetarët e bashkive nuk pyten mbi investimet, por thjesht investohet në atë që ka prioritet qeveria dhe jo në atë që përcjell kryetari i bashkisë, apo bashkia, që mund të jenë realisht shumë më prioritare për banorët sesa disa investime që mund të vijnë periodikisht. Nëse flasim sot për ndërhyrje, apo investime që janë domosdoshmërisht në bashki, janë, e jam i bindur që biem dakord edhe me kryetaren e Kurbinit. Janë pikërisht infrastruktura, qoftë rrugore, qoftë energji elektrike, apo shpesh në disa zona edhe ujësjellësit. Dhe nëse nga grandit dhe nëse nuk shihet kjo lloj balance, absolutisht që bashkitë me të ardhura të vogla, siç janë bashkia e Mirëditës, e bashki të tjera të karakterit malor, kanë varësi totalisht nga qeveria. Dhe aq më tepër që prodhojmë, pra prodhohet në territor, qeveria merr nga ato, nga ai prodhim aty dhe nuk kthehet. Dhe kjo është alarmante, kjo për mua është shqetësuese. Aq më tepër për grandin, për më falni, për rendin minerar, që është qesharake për ta diskutuar. Kjo nuk është në fakt, këtu ka një problem të madh mbi përllogaritjen që i bëhet. Kompanitë që punojnë, kompanitë që çdo vit nxjerrin, dalin me minus, e normalisht se s'ka si të marrë bashkia pastaj rend minerar. Në qoftë se një minierë, apo një fabrikë që prodhon, nxjerr bakër, krom, etj., me radhë, deklarohet që çdo vit del në humbje, apo një vit mund të dali, po themi, në norma shumë të ulëta fitimi, patjetër që do marrë, ashtu siç mori në 2025-ën, një pikë, ose 120 milionë të reja pjesë nga renda minerare. Që është qesharake, që po themi në 2024-n s'kemi pasur fare, sepse kompania ka deklaruar që është në humbje. Pra, nëse nuk preken në qelizë kjo formë nga ndërhyrja ligjore për të përkrahur bashkitë, qoftë për rritjen e rendes minerare, që renda nuk flasim vetëm për minierat. Në territorin e bashkisë së Mirëditës, ka qoftë pika të caktuara që prodhojnë inerte të tjera, që janë

absolutisht shumë me fitim për kompanitë, por që në fakt nga bashkia, nga ato kompani merr shumë pak.

Arbjan Mazniku:

Dhe këtu do të jetë një ndërprerje, sepse më intereson shumë ky temë. A mund të kemi një, nuk ka nevojë të jetë sot, po do na ndihmonte shumë të kishim një vlerësim, kur thoni: "Dëgjo, në bashkinë tonë kemi tre gurore, ne do donim që për këto ta kishim nga kaq në kaq. Ne kemi këtë minierë, do të donim që për të ardhurat minerare ta kishim nga 5 në 15%, në 50%, në 70%." Pra, të kishim një kërkesë specifike, të prekshme për këtë çështje, sepse dhe eventualisht, nëse ju mund të bëni një vlerësim, do të ishte shumë e udhës. Na ndihmonte shumë që të bëni një vlerësim, të thoni: "Dëgjo, po t'i kishim këto, ne do shkonim, do shkonte buxheti nga 5 lekë në 100 lekë, nga 10 lekë në 12 lekë, që të dinim një vlerësim të çfarë impakti do të kishte një ndryshim i tillë në buxhetin respektiv të bashkisë tuaj specifiku." Na ndihmonte ta vlerësonim këtë çështje, se e mirëkuptoj argumentin, po thjeshtë është shtesë për të njëjtin argument që thatë ju. Pra, nuk kam aty.

Albert Melyshi:

Jo, realisht është me shumë interes kjo temë, sepse nëse unë e them me kompetencë të plotë që nëse unë realisht nuk e di se sa konkretisht, se sa ato e kanë përqindjen e pagesës në qeveri, po themi në numra ekzakt, por nëse renda minerare do rritej nga 5 në 15% ose 20%, nëse po themi në Mirëditë që ka mbi 12 hece që prodhojnë energji elektrike për Shqipërinë, apo një hidrocentral që është ndër më të mëdhenjtë në Shqipëri, apo mbi pesë, apo gjashtë pika inertesh, apo të bazaltit që prodhojnë brenda territorit tonë dhe shfrytëzojnë burimet natyrore të Mirëditës, nëse këto do shikoheshin me prioritet nga qeveria, që të rritej përqindja që duhet jo të taksojmë më shumë kompaninë, por ajo që shteti merr nga këto kompani, të kthehej më shumë në territor, unë jam i bindur që nuk do të kisha nevojë si kryetar bashkie të trokisja pas çdo zyre për investime, apo për të dorëzuar projekte tek, qoftë tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, apo tek Ministritë e linjës që merren me investimet në territor. Pra, nëse kjo do shihje në raport me ato çfarë paguajnë në qeveri, dhe në raport me atë që duhet realisht të kthehej në burim aty ku mbledhet, unë mendoj që bashkitë, flas për bashkisë së Mirëditës, do kishte shumë më pak nevojë të kthehej dhe të kthente kokën nga qeveria për investim.

Arbjan Mazniku:

Ta dinim si numër do na ndihmonte kjo. Do sillem me këtë. Deri tani është mendimi i përgjithshëm, se ta dimë si numër.

Albert Melyshi:

Si numër në çfarë? Si numër, për shembull, kemi pesë kompani që prodhojnë inerte. Kemi sa merr nga renda sot? Në vitin 2025 kam marrë 1 milion e 200 mijë lekë të vjetra.

Arbjan Mazniku:

Po. Tani çështja është sa është përqindja sipas ligjit e rendës minerare që merren bashkia? **Albert Melyshi:**

5%.

Arbjan Mazniku:

Shumë mirë. 5%. 5% është fitimi.

Albert Melyshi:

5% e fitimit.

Arbjan Mazniku:

E fitimit. Tani çështja është nëse, në qoftë se pyetja që kam unë për ju do ishte, në qoftë se do ta 20-fishonim këtë, që do të thotë 100% të rendës minerare ta merrnit ju, nga 1.2 milionë ta bënim 20 milionë, do t'ia zgjidhte problemet bashkisë? T'i thoshim që: "Dëgjo, se kur ju kanë dhënë pesë, do të thotë që kanë mbajtur vetë në këtë pesën. Po t'jua jepshin 100% juve, do e zgjidhte problemin?"

Arbjan Mazniku:

Jo, unë do thoja këtë, që nëse ju më jepni, po them 100%. Do ta jap përgjigjen.

Albert Melyshi:

Nëse deklaramet e kompanive bëhen reale mbi atë që fitojnë, atëherë i jepi 15%, që nëse asgjë më shumë. Por duhet, pra, duhet të kontrollohet kompania se sa, po s'mund të dalë një kompani një vit po me shumë pak fitim dhe disa vite rrjesht me humbje. S'mund të ndodhë dhe ato vazhdojnë dhe vazhdojnë e punojnë.

Arbjan Mazniku:

Ndjesë se nuk dua të bëja debat. Më intereson shumë dhe nuk e them për ty, më intereson shumë realisht dhe nuk e them thjesht për ju, e them për të gjitha bashkitë, sepse ky është një argument i cili vjen në mënyrë sistematike. Nëse mundet, jo sot, na bëni një vlerësim, të thoni: "Dëgjo, në territorin tim unë kam këto burime minerare që janë në përdorim. Do të donim që për këto ta kishim normën nga pesë në 25, nga pesë në 90. E duam 100." Bashkë me argumentimin pse, se do të duhet dhe argumentim, se domethënë do të duhet të ndahet dhe logjika si shqendrohen resurset midis qeverisë vendore, qeverisë kombëtare, se janë ca dhe burime që janë dhe kombëtare, s'janë thjesht një qyteti. Me argumentimin tuaj na bën shumë punë ta kemi të shkruar këtë si komision. Po si komision, patjetër si komision. Si komision nuk ka nevojë të jetë sot, po thjesht për çështjen në vijimësi. Po, do. Faleminderit.

Xhelal Mziu:

Po bëj edhe vetëm edhe një gjë tjetër, ndjesë. A nuk do të ishte normale po morim vetëm Shkopetin dhe Ulzën, që janë Bashkia e Burrelit, Bashkia e Kurbinit, sa lekë merr nga sipërfaqja e zënë nga këto hidrocentrale? Sepse nëse do kishte qenë, po themi, pa hidrocentral, do kishte marrë, po themi, taksën e tokës, do kishte marrë produkte të tjera, zero merr. Përse?

Arbjan Mazniku:

I shiti Saliu atë si marrin këto? Po mos i shiti. Për çfarë e bëjmë se i shitën?

Xhelal Mziu:

Po çfarë keni blerë ju? Ato që ishin atje u shitën. Saliu ta la aty, po them, me kapacitete sa të duhesh prodhuese me hidrocentralet. Dhe njëherë, mos e thoja për këtë që përmendëm. Mos e devijoj. Mos e devijoj. Edhe njëherë, unë merrem, unë merrem, unë merrem me parim. Unë merrem me parimin t'i merresh me zhurmusin. Më thuaj, le të thonë dy kryetarët, janë apo s'janë dakord për të marrë taksë pasurie për tokat e zëna, qoftë nga minierat, apo dhe nga hidrocentralet? Unë mendoj që është më logjike, sepse Shqipëria e palët.

Arbjan Mazniku:

E folëm tek Durrësit atë.

Albert Melyshi:

Shiko. Do doja të shtoja, sepse të nderuar bashkëkryetarë, thjesht shumë guxim. Jo, më do ta kesh ti guximin të duhur. Do doja të sa e bini banorëve të dorës, na falni shqiptarë që keni sjellë këtë gjë. Çfarë? Do më lejoni të përfundoj?

Arbjan Mazniku:

Tani, të lutem që t'i qëndrojmë. Zoti Melyshi, të lutem, do jemi përgjegjës.

Albert Melyshi:

Vetëm në dy vitet e fundit, përsa i përket kompetencave, në dy vitet e fundit është realisht tentuar edhe një ndër kompetencat përsa i përket lejeve të ndërtimit jashtë, është marrë jashtë marrë bashkive. Unë nuk e them për Bashkinë e Mirëditës, se fatkeqësisht Bashkia e Mirëditës ka shumë pak përfitim nga kjo pjesë dhe fatkeqësisht ka shumë pak investime sa i përket ndërtimit. Por bashki, bashki bregdetare si e Lezhës, apo Tirana, konkretisht kryeqyteti, por edhe bashki të tjera të bregdetit që kryesisht kanë investime, kanë shumë humbje nga kjo marrje kompetence përsa i përket sipërfaqeve dhe lejeve të ndërtimit. Që për mua duhet, absolutisht duhet të vendimi i këshillit të ministrave për heqjen e këtyre kompetencave duhet të jetë në Gjykatën Kushtetuese për të marrë një feedback të qartë nëse ajo është raport me Kushtetutën ose jo. Është tentuar dhe ne e dimë përsa i përket Policisë Bashkiake, nuk mund të merren kompetenca bashkive që janë realisht fitimprurëse për bashkitë. Nëse bashkive do ju mungojnë këto kompetenca që janë fitimprurëse për bashkitë, atëherë jo vetëm prapë po ndërhyjmë në autonominë vendore, po ndërhyjmë në, ose po shkojmë drejt një centralizimi, por po ulim konkretisht të ardhurat që bashkitë mbledhin pikërisht nga kjo ndërhyrje në kompetencat e bashkive. Cila e ardhur? Do isha interesuar të dëgjoja. Po them për vendimin e këshillit të ministrave për lejen e ndërtimit. Mbi sipërfaqet, mbi sipërfaqet.

Arbjan Mazniku:

Si ka ndikuar kjo te ardhurat e bashkisë?

Albert Melyshi:

Unë nuk them, unë flas në të gjithë.

Arbjan Mazniku:

Ju ke ju e ke bashkive në përgjithësi. Po në bashki. Po ka ndërhyrë. Po taksën për nesër, taksën bashkia e marrë. Nuk është. Shiko.

Albert Melyshi:

Atëherë a do të shiko vetëm zoti kryetar, vetëm edhe një të fundit edhe pastaj shkojmë tek pyetjet tjera. Të fundit. Ideja është, ideja është nuk është vetëm tek të ardhurat. Ideja është tek ndërhyrja e kompetencave. Ideja është tek ndërhyrja e kompetencave dhe tek realisht tek ajo që ne e kemi gjithë prioritet si të majtë, si të djathtë, Bashkimi Europian. Pra nëse ne tentojmë dhe po duam të shkojmë atje, nëse këto ndërhyrje të qeverisë në kompetencat që kanë bashkitë vazhdon, patjetër që do duhet të çojmë legjislacionin shqiptar ose atë të bashkive në raport edhe me Bashkimin Europian që të jemi, bashkitë të kenë vërtetë autonominë e sa e tyre vendore dhe të jenë të decentralizuar.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit zoti Melyshi, zoti Malaj.

Luçiano Boçi:

Një ndërhyrje, jo, një ndërhyrje të vogël në raport me deklaratat që u bënë këtu ose përgjigjet e kryetarëve të bashkive. E kam për Kurbinin më shumë, sepse dëgjova që për arsimin në Kurbin ishin bërë investime përgjatë kësaj kohe më shumë se në 30 vitet marra së bashku. Se e kemi dëgjuar shpesh si formulë këtë, edhe për rrugët që s'do bëheshin për 500 vite, ka thënë njeri. 500 e ca vite s'do bëhesh ajo rrugë. Diku dëgjojmë që investimet janë për kaq vite të marra së bashku, s'janë bërë asnjëherë. Ndërkohë që keni një kontradiktë shumë të madhe në deklaratat tuaja, sepse njëkohësisht pranuat që s'keni burime financiare për kompetencën për arsimin parashkollor, apo jo? Ishte parashtrimi juaj që na është dhënë si kompetencë, por ne nuk kemi burime financiare për mirëmbajtjen e tyre. Pra të dyja nuk qëndrojnë, o njëra, o tjetra. Në qoftë se qëndrojnë, ka një arsye shumë madhore. Këto investime madhore që janë bërë përgjatë këtyre viteve erdhën për shkak të projekteve tuaja, për shkak të projekteve të qeverisë, apo pati një arsye natyrore shumë të madhe që ishte Tërmeti? Sepse unë e di që katër shkolla dhe dy kopshte që janë rindërtuar, janë rindërtuar për shkak të Tërmetit. Një pjesë me fondet e BE-së dhe nga fondet e rindërtimit. Dhe mos e shesim si sukses një fatkeqësi që dëshmoi midis shumë gjërave të tjera dhe paaftësinë e pushtetit vendor për t'ju gjendur pranë njerëzve. Edhe sot kemi vonesa në ndërtimin e shkollave dhe kopshteve. Ka vonesa. Nuk janë në dorën tuaj vonesat. Vonosat vijnë për shkaqe të donatorëve, për shkaqe dhe të firmave që kanë marrë përsipër t'i ndërtojnë ato. Pra në deklarata ne duhet të themi qartazi: në qoftë se ka një problem, ka një problem. Dhe ne e dimë shumë mirë që s'ka përputhje midis funksionit, kompetencës dhe aftësisë financiare që ka pushteti vendor. Dhe ne duam që ju ta kërkonit një gjë të tillë, sepse komisioni duhet të reflektojë në këtë pikë. Por në qoftë se ju thonit që është shumë mirë se janë bërë shumë ndërtime, se na ndodhi një gjë që s'duhet të ndodhte, kjo nuk përputhet. Pra ta ruajmë atëherë regjistrin e arsyes në atë masë që ne të marrim informacionin e duhur dhe normal të kemi atë refleksionin e duhur. Se i bie që duhet të ndodhë një tërmet tani që të ndërtohen shkolla dhe kopshte. S'duhet të dalim në këtë llogjikë. Faleminderit.

Majlinda Cara:

Faleminderit zoti kryetar. Ajo që është reale e investimeve është reale dhe s'kemi pse e fshehim dot nga bashkia, nga qeveria, apo nga fatkeqësitë natyrore, apo nga donatorë. Ka edhe nga këto që edhe nga donatorë, po edhe nga projektet që ka bërë bashkia, por edhe nga fitimet që janë marrë nga aplikimi i projekteve nga bashkia. Dhe kemi shkolla që janë bërë edhe nga bashkia. Unë besoj isha e qartë ndaj.

Luçiano Boçi:

Mirë, kryetare, na thuaj cilën shkollë ka financuar bashkia. Ju dëgjova me këtë. Bashkia cilën shkollë nga katër shkollat?

Majlinda Cara:

Do më lësh ta përfundoj dhe pastaj mund të përgjigjem. Të dëgjova.

Luçiano Boçi:

Po si zoti Mazdiku ju i kërkoi zotit Mlyshi, i tha: "Na thuaj, tha, sa është renta," tha. "Po merrim provime sa është renta." Kurse unë s'po bëj, jo, unë nuk po bëj pyetje tendencioze. Unë përmenda jo fare. Unë s'bëra pyetje fare njëherë. Unë bëra parashtrim dhe po marr një reagim për parashtrimin. Sa për dijeni, nuk bëra pyetje. Dhe meqënëse pata një kundërpërgjigje, katër shkolla janë edhe dy kopshte. Cilën ka bërë vetë bashkia? Se u tha që është bërë me fondet e bashkisë. Thjesht po cila është aftësia e bashkisë? Po nuk dua unë të nxjerr keq kryetarin e bashkisë, sepse po ndërtojmë një qasje të gabuar. Edhe kur bëjmë ne pyetjet, ka një kompleks, domethënë që ne duhet t'ju nxjerrim keq juve, jo fare. Normal është ajo frika që po e përsëris, se është një votues atje që dëgjon edhe thotë që nuk është drejtuar mirë bashkia dhe unë nuk e votoj kryetaren herës që vjen. Nuk është, duhet të heqim dorë nga kjo. Ne jemi këtu për të gjetur atë që nuk funksionon në bashkitë e Shqipërisë. Jo se është Berti i djathtë dhe Majlinda është e majtë. Pra unë dua që nesër edhe Majlinda dhe Berti të kenë fonde për të bërë një shkollë që duan ta bëjnë. Se në qoftë se do bëja pyetje, të them: "Shkollat po i keni rindërtuar, rikonstruktuar, sa ka rënë numrin e nxënësve? Sa janë klasat kolektive?" Këto do ishin pyetje tendencioze, sfiduese, se normal që gjëra të tilla kanë ndodhur. Dhe unë thashë që këtu të dalin problemet. S'duhet të ndodhë tërmeti që të bëhen shkollat. Fare. E heqim. Ai ishte një momentum jo i mirë që u përkthye dhe pastaj në një ndihmë që erdhi nga komuniteti ndërkombëtar, apo format e tjera të financimeve nga BE-ja. Po jo ta marrim ta paraqesim si sukses të mirëfunktionimit të pushtetit vendor. Ne duhet të nxjerrim problemet këtu. Nuk po marrim në gjykim punën e kryetarëve të bashkisë. Ne po themi bashkitë si duhet të funksionojnë, çfarë mbështetje duhet të kenë në fonde, në rentë, në autonomi, në kompetenca, dhe sigurisht duke debatuar pak bashkë, po jo duke u nisur nga komplekset. Zonja Cara, nuk e kisha me atë pyetjen.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Zoti Malaj, kisha pyetje.

Agron Malaj:

Atëherë, përshëndetje. Në vitin 2016, ne kemi miratuar një ligj ku bashkitë mund të jenë bashkëfinancuese, duke u marrë nga pjesa që zoti Mlyshi, miku im, e tha që pjesën e lejeve të ndërtimore, apo hyrjen në kompetenca. Në të vërtetë, ne nuk kemi, nuk është hyrë në kompetenca, sepse në 2016 është miratuar një ligj ku bashkitë mund të jenë pjesë e ndërtimeve, apo si bashkëpronare, apo si bashkëfinancues, apo si bashkëndërtues të ndërtimeve, siç mund të jenë pallate, apo objekte të ndryshme. Dhe mendoj që këtu është zgjeruar pak gama e kompetencave. A ka raste në dy bashkitë rast të tillë që ju keni nisur sipërmarrje të tillë me përqindje tokave shtetërore në pronësinë tuaj për investitorë të ndryshëm, apo për ato palë të interesuar? Dhe tjetra, këtyre heceve, se ne kemi ngelur te renta minerare. Në të vërtetë, nuk është vetëm renta minerare, është edhe pjesa mjedisore, taksës mjedisore, ku në të vërtetë shumë bashki nuk e kanë përfshirë. Kemi

vetëm disa raste si Bashkia e Librazhdit, Bashkia e Kuksit, apo tashmë së fundi Bashkia e Matit, para dy-tri muajsh, ku jo më pak, po janë në miliona lekë që ne nuk i mbledhim nga këto subjekte, siç është dhe Bashkia e Mirëditës, që ka goxha pjesë të këtyre heceve. Dhe e treta, në fakt, plani i zhvillimit të territorit që ne kemi, që çdo bashki duhet ta ketë përmbyllur, nuk e di a e ka Mirëdita e apo e ka Laçi, duke qenë se në planin e zhvillimit të territorit shumë bashki nuk i kanë plotësuar, nuk i kanë përfunduar, apo nuk i kanë miratuar, na lind edhe kjo problematika tjetër që, siç kemi këto ndërtimet pa leje, apo siç kemi këto legalizime të mbartura ndër vite, e vite, e vite. Këto nuk janë pyetje, janë thjesht edhe për të sqaruar mbi atë që folëm, që folëm më përpara. Tashi, një pyetje të fundit, një pyetje kam unë: A ka mundësi Bashkia Mirëditë dhe Bashkia Laç në të gjithë territorin e saj?

Një pyetje të fundit, një pyetje kam unë. A ka mundësi Bashkia, mirëdita Bashkia Laç, në të gjithë territorin e saj, ka mundësi t'i ushtrojë gjithë funksionet e saj ndaj komunitetit? Ka kapacitete ta bëjë këtë? Pra, duke filluar nga pyjet, nga rrugët, nga kanalet vaditëse, e me radhë e me radhë, apo nga kontrolli territorial, apo nga, po qoftë edhe policia bashkiake, qoftë edhe IMT-ja, kaq kisha.

Albert Melyshi:

Mirë, faleminderit zoti deputet. Në fakt, në thelb, duke qenë që je edhe ish-kryetar i Bashkisë së Matit, dhe e njeh shumë mirë pushtetin vendor, dhe këtë jam i bindur, edhe ju besoj e dini shpesh pengesat që bashkive ju dalin, qoftë edhe për momente të caktuara që në bashki paraqiten, qoftë investitorë, shëndet, që në bashki paraqiten qoftë investimet tuaja, qoftë investitorë, qoftë edhe popullsia vendase që ka dëshirë të investojë. Dhe unë mendoj që do të ishte të gjendet një mekanizëm, dhe këtu dalin problemet, duhet të gjendet një mekanizëm për sa i përket rishikimit që bëhet shpesh të planit të përgjithshëm vendor. Apo raste që bashkitë i kanë vërtetë me prioritet për t'i zhvilluar zona të caktuara dhe që shpesh pengohen nga, pikërisht nga vonesat për të rishikuar planin e përgjithshëm vendor. Dhe aq më tepër që në dy vite që parashikohet të rishikohen këto plane, ndodh që të mos kesh përgjigje edhe tre, katër vite tjera. Dhe këtu mendoj që, nuk e di sa ndjek zoti Mazniku, pasi e ka, mbetoj se ka, ka njohuri të thella të kësaj pjese. Mendoj që është e domosdoshme që të gjendet një zgjidhje për sa i përket rishikimit të planeve vendore. Sepse shpesh gjejmë pengesa në kuptimin e kohës, e ligjit, në ndryshimet që kërkohen për interes komunitar, pra në këto, në këto plane të përgjithshme. Dhe ose të gjendet mekanizmi që këto plane të rishikohen më shpesh sesa një herë në dy vite, ashtu siç e parashikon, ose të shtohen kompetencat e bashkive se si mund, kur janë për interes komunitar, të rishikohen. Pasi shpesh kjo është pengesë thelbësore për, unë mendoj, të paktën flas për bashkinë time, por jam i bindur që kjo ndesh shpesh edhe për bashki të tjera. Kur fola për.

Arbjan Mazniku:

Një ndjesë që ju bëj prapë, se nuk dua ta bëj kështu, por meqenëse është pikë që më, më, më volit. Keni pasur probleme me ndryshimin, keni me planin?

Albert Melyshi:

Po, patjetër.

Arbjan Mazniku:

Dhe mendoni që duhet ndërruar më shpesh se një herë në dy vjet?

Albert Melyshi:

Po, patjetër. Ose të gjenden kompetencat tjera që bashkitë, qoftë edhe me, me, me mekanizma të tjerë, të mund të ndërhyjnë për t'i rishikuar. Ndërsa për atë që tha zoti deputet, ishte ideja që Bashkia e Mirëditës dhe Bashkia e Matit, apo bashki të tjera, nuk preken nga kjo, sepse fatkeqësisht në Mirëditë nuk ka ndërtime pallatesh. Edhe i bindur që edhe në Mat nuk jemi sigurt. Por bashki të tjera, bregdetare kryesisht, dhe e Tiranës, preken nga kjo. Dhe këtu nuk është ideja heqja e kompetencave të pushtetit vendor. Është shpesh ideja që grumbullimi i këtyre kërkesave në një pikë, siç mund të jetë ajo AZHT-ja, përbën vonesë edhe për qytetarët. Pra që shtjellimi i një kërkesë për investim që mund të jetë nga një investitor, do i duhej me, me, me shumë kohë, do i duhej shumë kohë për të marrë përgjigjen ose për të, për të marrë lejen, po themi në AZHT, kur bëhet fjalë për, për kërkesa të caktuara.

Agron Malaj:

A ka edhe, a ka përsëri, pastaj ti e ke në sistem? Edhe për ta miratuar, kryetari i bashkisë, apo bashkia ka në sistem miratimin paraprak të një ndërtimi? Nuk besoj se.

Albert Melyshi:

Sa i përket.

Agron Malaj:

Ka probleme të tilla?

Albert Melyshi:

Sa i përket kapaciteteve, për shembull, bashki i Mirëditës mund të kesh në raste sporadike mungesë kapacitetesh, por që kemi gjetur mundësinë për t'i alternuar dhe absolutisht edhe i kemi të zgjidhura. Nuk është problemi tek kapacitetet sa është tek financimet. Pra mungesa e buxhetit, mungesa e të ardhurave është problemi kryesor. Kapacitetet janë mundësi pastaj të zgjidhshme, gjeihen mundësi alternative me bashki të tjera, me. Pra ka të gjitha variantet për të gjetur zgjidhje. Në momentin kur s'ke financat, që do të duheshin kapacitete.

Arbjan Mazniku

Po, ka pyetje? Po? Po, kalojmë për këtë dorën. Zoti Nallbati?

Bledion Nallbati:

Po, thojeni atë. Po, por e vetëm të kënaqeni juve kur thoni ç'të doni.

Arbjan Mazniku:

Zoti Nalbati, nuk është përgjyer bashkia Kurbinë, dhe menjëherë pas keni fjalën.

Majlinda Cara:

Së pari duhet t'i them Agronit, zoti deputet, më fal, por. Bashkia e Kurbinit, jo, jo Laç, sepse shpeshherë e përdorin Laç dhe në fakt është, është kur është bashki më e madhe Kurbini. Ëh, ne në fakt nga, nga pyetja që drejtoj zoti deputet, ne i ushtrojmë kompetencat, ne i

ushtrojmë të gjitha kompetencat që na jep ligji. A i ushtrojmë këto në disa fusha më mirë, apo pak më mirë në disa fusha tjera, por që ne mundohemi që ta japim shërbimin për të gjitha ato kompetenca që na ushtrojnë. Dhe këtu unë më lejoni, ndoshta do duhet të jap një mendim. Në disa fusha kryesore unë mendoj që duhet të kemi edhe një bashkëpunim më të mirë me, me bashkitë, një bashkëpunim që me, me të gjitha bashkitë e Qarkut, apo rajon, nëse quhet, që në fakt ne për hir të së vërtetës si me Albertin, po edhe me Lezhën, me Pjerinin, e kemi pasur ë korrekt bashkëpunimin, por ndoshta mund të shtrihej një bashkëpunim më i gjerë edhe i, i dedikuar edhe në ligj. Dhe këtu ndoshta bashkia, flas për bashkinë time që kemi pasur shumë vështirësi, ndoshta në emergjenca civile, dhe ky mund të jetë një nga aspektet që mund të shtrihet edhe përtej bashkisë së Kurbinit. Pra mund të jenë kompetenca që mbulojnë gjithë Qarkun. Ëh, mund të shtrihemi patjetër ndoshta edhe në menaxhimin e mbetjeve për të gjithë Qarkun. Pra për t'i bërë ndoshta më mirë ushtrimin e këtyre kompetencave që ne sot i kemi, por diku e bëjmë punën më mirë, diku e kemi të pamundur për shkak të financave për ta bërë më mirë. Dhe një propozim që një strukturë ë në Qark do ishte për ne zgjidhje për të ushtruar më mirë kompetencat dhe për të qenë edhe në shërbim të qytetarëve.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Zoti Nallbati?

Bledion Nallbati:

Po, faleminderit. Atëherë ë do t'i bie shkurt pa ndonjë referat të gjatë. Ë cilat janë shërbimet që ju nuk i realizoni dot në cilësinë e duhur dhe cila është arsyeja që nuk e realizoni dot këtë, këto shërbime? Është mungesë kapacitetesh, siç thuhet shpesh këtu për bashkitë e vogla, apo është mungesë suporti financiar mbi këto shërbime? Dhe nëse e keni këtë suport të duhur financiar, a e realizoni dot, apo është e pamundur dhe këto shërbime, siç rastin që sapo përmendët ju, ë emergjencat civile do të duhet edhe njëherë të riqëndërzohen, apo të, të, të rimerren sërish, po themi, në nivel Qarku, rajoni, nga, nga, nga qeveria dhe të mos, mos ta ketë më bashkia. Pra për ta bërë më të kuptueshme, nëse ju për shërbimin ë e zjarrfikës dhe të mbrojtjes nga, nga zjarri do të keni një suport më të mirë financiar për të pasur mundësinë për që të keni mjete, mjetet e duhura dhe personelin e duhur të mirëpaguar, mund ta realizoni dot këtë shërbim, apo nuk ia dilni dot dhe do duhet të shkoni në variantin që thatë ju, ë të një rajonalizimi të këtij shërbimi dhe të heqjes së këtij shërbimi nga, nga pushteti vendor. Por më ndonjëherë po do doja një, një përgjigje se cilat shërbime tjera ju nuk i realizoni dot në cilësinë e edhe në kohën e duhur. Dhe pse çalon kjo? E para. E dyta, dëgjova ë kryetaren e bashkisë së Kurbinit që foli për sukseset e bashkisë së Kurbinit ë dhe tha që të gjitha këto investime që janë bërë në bashkinë e Kurbinit kanë qenë si rezultat i madhësisë së saj. Dhe po e citoj në fund të fjalës, a kanë qenë si rezultat i madhësisë, pra i grupimit të njëësive vendore. Nëse ecim në këtë logjikë, mendoni që qytetarëve të Kurbinit, bashkisë së sotshme të Kurbinit, do t'u shërbejë më mirë nëse e shkrijmë bashkinë e Kurbinit dhe e bashkojmë bashkinë e Lezhës? Pra e bëjmë më të madhe nga ana e territoriale edhe të fuqisë ekonomike. Ë sepse kështu ky ishte modeli që ju thatë. U bë më e madhe, u bë, u bënë gjithë këto investime. Atëherë të ecim në këtë logjikë. E shkrijmë edhe bashkinë e Kurbinit, një propozim që vjen nga, nga mazhoranca dhe jo konkretisht për bashkinë e Kurbinit, por në total për që janë për një shkrirje, për një shkrirje të disa bashkive dhe për, për uljen e numrit të bashkive. Ë ja një sekondë, ta mbaroj se pra nëse bashkinë e Kurbinit sot e shkrijmë, apo edhe të Mirëditës, dhe e bashkojmë me bashkinë e Lezhës, a do t'u shërbehet më mirë qytetarëve të bashkisë së Kurbinit, kur flas bashkisë së Kurbinit, jo vetëm qytet, por edhe në çdo skaj të saj? A do ishte kjo në interes të tyre? A do t'ju afroreshin shërbimet më cilësore dhe,

dhe në kohë më të shpejtë? Apo do të, do të preferonit një opsion tjetër të qëndrimit të kësaj harte territoriale, por duke fuqizuar kompetencat dhe financat që do të duhet të shoqërojnë këto kompetenca? Sepse ë si shumë prej nesh, një pjesë e madhe e kolegëve që janë në këtë komision, edhe unë kam shërbyer pak si kryetar bashkie dhe e kam përjetuar në vetë të parë problematikën që ka pushteti vendor si porta që përballet me qytetarët për të gjitha problematikat që ka qytetari, duke e nisur edhe, edhe nga ato që nuk i përkasin fare bashkisë. Qytetari ka probleme me energjinë elektrike, vjen te bashkia. Se atë ka, atë gjen atë ka votuar. Se është sot që flasim, republikën e Shqipërisë, i vetmi ë pushtetar i votuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetari është kryetari i bashkisë. Ne të tjerët ca nga lista se është liste, kështu është sistemi. I vetmi, i vetmi. Shiko, dëgjo, dëgjo, dëgjo. Meqë, meqë ngrini dorën kështu për të thënë fol për vete se ju që keni qenë jasht liste, po jeni më, më të mirë se ne të tjerët. Atëherë po flet me mua që unë e kam, e kam provuar dy herë përballjen në drejtpërdrejtë, edhe si kryetar bashkie, edhe si deputet. Sa radhe kam qenë pjesë e listës së mbyllur. Kështu që nuk kam, nuk më kompleksioni te kjo gjëja. Ne jemi këtu jo për të folur kush nga ne është më i miri, por për të thënë, për të thënë edhe mi i zoti, por për të, për të gjetur zgjidhje, për të gjetur zgjidhje për problematikat e qytetarëve. Kështu që nuk, nuk e kam, e kam provuar atë gjënë unë. E kam kaluar para jush, para jush, para jush, para jush. Ë ndaj ë pra edhe njëherë do të preferonit ju meqë thatë kur u rigrupua tre njëësitë apo katër njëësitë e Kurbinis dhe u bë një bashki, falë këtij grupimi dhe kësaj madhësie, u bënë gjithë këto punë. A do të ishte më mirë ta shkrimisim? Dhe e fundit, do të preferonit këtë ndarje territoriale, një ndarje me më pak bashki, apo një ndarje me më shumë bashki? Dhe kur them do të preferonit, jo në nivel personal, po në opinionin tuaj si kryetar bashkie, duke pasur edhe, edhe ë kontaktin dhe drejtpërdrejtë me qytetarin dhe, dhe e dini mirë se, se, se çfarë qytetarë preferojnë. Këto kisha. Faleminderit.

Ermal Elezi:

Po pra për procedurë. Tani, kur e nisëm seancën e çparshme, u tha që s'ishite pjesëmarrje e kryetarit të bashkisë. Kryetarë bashki tani që nuk erdhën, u respektojnë. Ndërkohë kemi vetëm një përfaqësues nga opozita gjithsej. Jemi shtatë tetë veta nga krahu tjetër. Kjo ideja është, kjo tregon seriozitetin kur e ja kërkojmë të tjerëve. Kemi dy kryetarë që po i dëgjojmë. Ja kërkojmë të tjerëve, duhet ta japim dhe vetë. Dhe kjo mendoj që nuk është ë serioze për të, për të ndjekur punimet.

Bledion Nallbati:

Tani, meqë jam i vetmi përfaqësues, po tani kështu e bë tallava. Tani kështu ju them unë. Meqë jam i vetmi përfaqësues i opozitës, mund ta mbrojt në buxhet. Po jo, po s'kam nevojë. S'kam nevojë. Kështu që, zotit, kur të kem nevojë, do t'ju kërkoj mbrojtje edhe ndihmë. Ë deri, deri më tani kishit këtu përfaqësues të opozitës të cilët kanë bërë pyetjet e veta ndaj kryetarëve të bashkive dhe do t'i keni sërish këtu pa merak. Po ju mori malli. Po i njoftoj të vijnë çik më shpejt se ë që të mos, mos mallëngjeheni kaq shumë. Të presim përgjigjet e kryetarëve të bashkive dhe kryetares. Ë në këtë rast, meqënëse kërkuat mos bënim shumë parashtrimeve, unë besoj që isha shumë shkurt kësaj rade në, në, në pyetjet që bëra dhe nuk bëra parashtrime të gjata. Kështu që sa më shumë ta, ta zgjasim tallavan, aq më keq është.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, z. Nalbati. Kërkoj që t'i japim përgjigjet ë e duhura.

Majlinda Cara:

Së pari, deputet, ë deklaratat besoj i dëgjuat dhe ju, po dhe unë këtu, dhe shpresoj fort mos ta tejkaloni në koncepte të tjera deklaratat e mia. Unë nuk thashë për territorin dhe ndoshta që në momentin e parë thashë territori i bashkisë së Kurbinit nuk ka nevojë të preket, por në krahasimisht me komunat, me reformën e 2014-s, thashë që bashkia më e madhe performon më mirë dhe dhashë tre katër arsye pse bashkia e madhe performon më mirë deri këtu në territore, pa kaluar në ato mendime të tjera që i thoni ju që unë nuk i shpreh dhe qytetarët në fakt e dinë shumë mirë. Deri këtu te territori ku jemi, bashkia Kurbin pa shkuar më tej, dhe këtu është e mjaftueshme për të qenë bashkia Kurbin pa e prekur në territorin e saj, pa thënë as për të shkuar te bashkia Lezhë, as për të ardhur bashkia Mirëditë te bashkia Kurbin. Që në fillim të herës, ashtu nuk jam. Këtë ndoshta e dinë ekspertë më shumë sesa ne, dhe në mendimin tim është bashkia Kurbin as të cënohet, as mos të preket për zmadhim, as mos të preket për zvogëlim nga territori. Kjo ishte. Dhe e dyta ishte që këto ishte për bashkëpunim ndërbashkiak të shërbimeve. Nuk thashë që të hiqen kompetenca nga ne. Thashë të ishin të bashkëpunim ndërbashkiak që ne, për hir të vërtetës, e kemi pasur të tre bashkitë, dhe kjo mund të forcohet edhe më tej. Dhe duke i hequr këtë territorit, janë për forcimin e kompetencave të bashkive dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Kurbinit. Tani, sukseset e bashkisë Kurbin ne kontratën e kemi të lidhur me qytetarët. Nëse qytetarët i shohin suksese, aty jemi, aty do jemi. Këtu po flasim për reformën territoriale administrative. Po japim mendimin tonë personal, po edhe të qytetarëve që i takojmë çdo ditë, dhe besoj kemi kërkuar si të gjithë kryetarët e bashkive atë që ne mendojmë të jetë më mirë, sepse unë mendoj se çdo reformë që vjen, vjen për të bërë ndryshime, se pastaj nuk quhet reformë. Nëse vjen për t'i bërë këto ndryshime për mirë, patjetër dhe kryetarët e bashkive do jenë ë në lartësinë e duhur. Ama shërbimi i qytetarëve nuk ka munguar ë diku më mirë, diku pak më mirë, e thashë dhe përpara, por që ë shpresoj fort që këto kompetenca që ne kemi pasur të deleguara, kemi pasur që në fillim të kryes herës e thashë që kemi pasur vështirësitë financiare për t'i përballuar kryesisht ne bashkitë e vogla. Ndërsa ajo e investimeve e sukseseve është evident, e shihet. Kështu që nuk është për ta shidhur. Këtu kemi kohë, kemi kohë për ta shidhur, por nëse do të duhet për ta zmadhuar bashkinë e Kurbinit, Mirëdita gati për t'u bërë bashkë me mua.

Arbajn Mazniku:

Zoti Melyshi,

Albert Melyshi:

Po e marr shkak nga fjala e fundit. Në fakt, e gjithë qarku, që ta dinë disa nga deputetët që mund të mos kenë informacione shumë për qarkun Lezhë, mbi 65% e gjithë qarkut është me mirëditor. Nuk e di sa, sa e keni këtë informacion. Kështu që, kështu që nëse, nëse Mirëdita realisht ka nevojë për të ta zhvilluar, mund të shiheshin dhe mund të diskutoheshin disa variante reale të zhvillimit të saj. Ë për shembull, edhe ja po të them një për shembull, ë unë e kam diskutuar dhe shpesh e kam ngritur edhe si, si çështje. Për shembull, nëse Mirëdita do i jepej ë lidhja me bregdetin që e lidh drejtpërdrejtë ë deputeti që është i Lezhës, e dinë shumë mirë që janë pjesë të cilat lidhen edhe me territorin i cili banohet nga, nga një përqindje e lartë me, me mirëditor që është bregdeti i Tales, do jepte mundësi zhvillimi ë pastaj pa patur nevojë që të të jetë e mbaruar nga financat që mund të dërgojë socio-qeveria. Dhe një menaxhim i tillë me, me bregdetin e Tales do jepte bashkisë së Mirëditë absolutisht një mundësi zhvillimi të vetvetes pa patur ë nevojë për, për të tjera financime. Po, po, po patjetër. E them edhe në faktin që janë disa lidhje ë edhe

disa lidhje të tjera të ndjeshme të popullatës dhe të territorit me, me Mirëditën. Kështu që pra jam i bazuar, jam i bazuar në disa, jam i bazuar në disa komponentë që e lidhin territorin.

Ermal Pacaj:

Një ndër arsyet sepse unë flas më pak se të gjithë te ky komision është se kam qejf me një gjuhë edhe me një gjuhë dhe shokët. Shokët nuk kanë qejf me një gjuhë mua, por është s'ka problem. Ë ajo që desha të pyes unë, në qoftë se mund ta bëj një pyetje ndërmjet, është që për këtë territorin, sepse normalisht ne, ne ndiqemi edhe çdo lloj diskutimi të tillë, ne ka dhe ndjeshmëri atje ku jemi. Ë për këtë territorin që thuhet dhe kjo ideja e daljes që ekonomikisht ë edhe është e leverdisshme për bashkinë tuaj, a baz a është pjesë e 100 e 1700 km² që pretendohet që të shkojë në kufijtë e vjetër njësia juaj administrative, apo është një logjikë tjetër që s'ka të bëjë me këtë? Faleminderit.

Albert Melyshi:

Në fakt, ë aty ke dy njësi administrative që preken. Njësia, njësi administrative Zejmend, që ka qenë pjesë e territorit të, të vjetër etnografik të Mirëditës, dhe ë njësia Shën Kollë, e cila realisht nuk ka qenë pjesë, po themi, e hartës etnografikisht të bashkisë së Mirëditë. Por ama që është e lidhur drejtpërdrejtë për shkakun që 80% e popullsisë aty janë të rënë nga Mirëdita. Kjo është ë lidhja që e them në aspektin ekonomik që mund të jetë mbi 80%. Shën Kollë, besoj e dinë shumë mirë që Shën Kollë është, është ndër njësitë administrative ë të Lezhës, që është pothuajse e gjitha mirëditore. Mund të shkojmë tek, tek ë Talia, mos gaboj, që është 50-50 me Malësor, por që pjesa më e madhe e Shën Kollit është mirëditore. Këtë është e shikueshme dhe mund të, mund të nxirret. Kjo është në interesin, e thashë, në interesin ekonomik realisht të zhvillimit të Mirëditës edhe të zonës. Ndërsa për të dalë pastaj tek dy pyetjet që deputeti bëri përsa i përket shërbimeve që nuk i realizojmë, a ka shërbime që bashkitë nuk i realizojnë? Në raport me të ardhurat, për shembull, përmenda që Bashkia e Mirëditës sot ka mbi 700 km rrugë rurale që respektivisht duhet të mirëmbahen nga, nga vetë bashkia. Tani thjesht hyjmë në një logjikë se si mund të mirëmbahen nga një bashki si e Mirëditës, me aq të ardhura sa ka, 700 km rrugë, besoj secili prej nesh e bëjmë kalkulimin që është pothuajse e pamundur. Dhe kjo pastaj do të duhej ajo që të dalim tek ajo kërkesa që kisha qenë në fillim, që këtu do të duheshin të shikoheshin pikërisht financat vendore dhe mënyra se si ndahen granditë i përvitshëm për bashkitë, apo qoftë edhe tek ndihmesa që realisht dhe këtu e kam, besoj do të doja zotin Maznikut më ta kishte vëmendjen, sepse është shumë me shumë interes. Shpesh bashkitë si Bashkia e Mirëditës apo Bashkia, jam i bindur që për këtë vështirësi ndodhet edhe Bashkia e Kurbinit, që shpesh ndodhin në vështirësi në mbledhjen e të ardhurave. Dhe ë kjo për shumë arsye, qoftë tek, tek taksa e pronës, që është një ndër tarifatat, një ndër të ardhurat më të rëndësishme që mund të ishin në bashki. Por këtu do të kishte një mekanizëm, besoj, ndihmues edhe nga, nga qeveria. Nëse flasim për shembull për shpesh për gjobat që vjelin policitë bashkiake, vijnë si efekt i një marrëveshjeje që bashkitë bëjnë me, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. Dhe kjo është një asistencë që nëpërmjet sistemit të gjobave të policisë së shtetit, bashkia ka aksesin për të vjelur edhe, edhe gjobat. Ndërsa për taksa dhe tarifa që siç janë, qoftë pastrimi, apo qoftë taksa e banesës, apo taksa dhe tarifa të tjera që realisht bashkitë dhe, dhe ë administrata e bashkisë ndihen në vështirësi në mbledhjen e këtyre të ardhurave, duhet të kishte një mekanizëm tjetër që të ishte në asistencë të bashkive, qoftë edhe në një marrëveshje drejtpërdrejtë mes bashkive dhe endeve të tjera, siç mund të ishte OSHE-ja, apo në një mekanizëm tjetër që ë qeveria mund të asistonte në këtë rast të bashkitë. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Po të lutem.

Bledion Nallbati:

Faleminderit. Atëherë ë e nderuar zonja kryetare, meqënëse më thatë që ju deformova fjalën, duhet të dini që këtu kjo mbledhje është e regjistruar. E gjitha është në media, po edhe ne mund ta kthejmë dhe ta ridëgjojmë. Unë nuk pretendova dhe as ju akuzova për asnjë gjë në lidhje me ato që thatë me sukseset e bashkisë. Nuk thashë që nuk qëndrojmë, nuk e njoh zonën. Ë unë ju citova ju pikërisht në momentin e fundit të fjalës suaj, kur ju përgjigjet zotit Mziu, pasi përmendët një sërë suksesesh, në fund thatë: "Të gjitha këto janë realizuar për shkak e një arsye. Arsyeja kryesore ka qenë madhësia e bashkisë." Dhe referuar kësaj, unë as thashë të shkruheni, të ju pyeta. Nuk thashë, nuk vendosa unë. Ju pyeta nëse në këtë logjikë që ju përmendët është më mirë, a do bëhet më mirë për qytetarët, sikur kjo bashki të bëjë më e madhe. S'ka rëndësi, shkoni të ju te Lezha, po vijnë te Lezhat e ju. Nëse vijnë Lezhat e ju, do të ishte pyetja për banorët e Lezhës, të bashkisë së sotshme të Lezhës. Pyetja ishte: a është më mirë që ta, ta rindërtoj edhe njëherë? A është më mirë për qytetarët? Dhe kur flas për qytetarët, flas jo vetëm qytetarë në qendër të bashkisë, por edhe ata në skajin më të largët, që territoret e bashkive të zmadhohen, të ulët numri i bashkive dhe të zmadhohen territoret, dhe në këtë mënyrë marrin shërbim më të mirë, më të shpejtë në çdo cep të bashkisë? Apo është më mirë kështu siç është, apo do të duhet të zvoglohet numri që të jetë shërbimi më afër qytetarit? Kjo ishte pyetja ime. Nuk ju deformova fjalën fare, as ju kundërshtova mbi sukseset që ju pretenduat, se nuk e njoh thashë bashkinë tuaj, dhe nuk më përgjigjet aspak për pyetjet që bëra. Thashë: a keni shërbime të cilat nuk realizoni dot si duhet, pra me cilësinë, në opinionin tuaj, në cilësinë e duhur dhe në kohën e duhur, dhe pse çalojnë këto shërbime? Çalojnë për paaftësinë tuaj si administratë, për pamundësinë që ka kjo bashki për të pasur kapacitete për t'i realizuar njerëzore, për t'i realizuar këto shërbime, apo për pamundësinë financiare që kanë bashkitë për shkak të mosfinancimit si duhet të funksioneve nga ana e qeverisë? Sepse thashë, unë e kam përjetuar vetë. Në 2015-ën u deleguan disa funksione, por pa mbështetjen financiare. Kjo ishte pyetja. Nuk kisha asnjë synim, as t'ju sulmoj, as t'ju muaj sukseset, as fitoret historike të juajat, e as të partisë suaj, se ne e dimë që kjo parti, e kjo qeveri, shkon nga fitorja në fitorje. Ne kemi të qartë këtë punë këtu. Unë e kisha konkrete gjën.

Arbjan Mazniku:

Ok. Faleminderit, zonja Nallbati. Ka një pyetje zotit Pacaj dhe më pas zonja Kuçeku. Unë ju uroj t'i bëni të dy pyetjet. Ë dhe meqënëse jemi dhe në kohë përfundimtare, është dhe korça që ka ardhur. T'i bëni të dy pyetjet dhe më pas të marrim përgjigjet dhe të bëjmë përmbylljen e kësaj seance.

Ermal Pacaj:

Faleminderit, kryetar. Në fakt, unë, unë nuk është se kisha një pyetje. Unë do të kërkoja më shumë vetëm një opinion nga zoti Mlyushi, Mlyushi kryetari i bashkisë së Mirëditës. Zoti Mlyushi, në fakt, përgjatë kësaj periudhe unë e kam ndjekur dhe gjerësisht dhe për t'ju përgëzuar, në fakt, për disa takime dhe dëgjesa që ju keni zhvilluar atje me intelektualët e Mirëditës përsa i përket pjesës së reformës territoriale dhe administrative. Ë dëgjesa me njerëz intelektualë të Mirëditës, se duhet të themi, të themi të vërtetën, Mirëdita ka qenë një ndër shtyllat ose djep i intelektualëve, jo vetëm në, në, në zonën tonë

të veriut, por në gjithë Shqipërinë edhe në rajon, madje. Është opinione atje nga intelektualë mirëditorë, qoftë historianë, profesorë, njerëz të kulturës. Është unë i kam ndjekur dhe e kemi marrë, e kam marrë feedback-un nga larg për ato dhe normalisht që opinionet e tyre na interesojnë. Por unë, në fakt, unë isha i interesuar për opinionin tënd personal si administrator i Mirëditës sot, si kryetar i bashkisë së Mirëditës sot. Është ajo çka ti citove më përpara si një propozim të gjithë asaj tryeze, edhe përtej asaj tryeze të komunitetit mirëditor, për një rikthim të Mirëditës në ato kufijtë e 1700 km², që në fakt janë kufijtë realë të Mirëditës administrativisht si administrator. Në qoftë se ne do kemi nesër një bashki të madhe të Mirëditës, a do ishte më mirë apo do ishte më keq për ty si administrator për Mirëditën? Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zonja Kuçeku. Besoj t'ia bëni dhe ju pyetjen dhe pastaj t'i mbledhim të dy përgjegjjet. Ja ta bëj dhe kjo që t'i bëjmë një një kështu.

Marjana Koceku:

Faleminderit, kryetar. E nderuar zonja Cara, i nderuar zoti Mlyushi. Për Kurbinin, me aq sa paraqet edhe raporti, analiza financiare që është bërë për qarkun Lezhë, Kurbinin ka shpenzimin më të lartë administrativ në qark. Pra, shpenzime shumë të ulëta në rrjetin rrugor dhe në ujitje, çka tregon një joefektivitet alokues të burimeve dhe një shpenzim shumë të nëntë tek pjesa e administratës. Ju si kryetare, si e mendoni që reforma mund t'ju ndihmojë që ta përmirësoni këtësoj defekti që paraqet, që këtë lloj defekti që e paraqet edhe analiza financiare e vetë të qarkut? Ndërsa për Mirëditën, u përmend edhe pak më përpara, në fakt, rrethanat historike, kulturore dhe vetë gjeografia e mbajnë Mirëditën një ndër zonat më homogjene, në mos zona më homogjene nga të gjitha bashkitë e Shqipërisë, duke pasur parasysh gjithë faktorët socialë. Por pavarësisht kësaj, potenciali dhe mundësitë që ka vetë natyrale Mirëdita për me pasë një zhvillim, besoj, shumë më të nëntë që ka, duke marrë parasysh edhe turizmin që ka pësuar një rritje vitet e fundit, po besoj mund të jetë shumë më mirë se kaq. Si mendoni ju që po ashtu mund të shërbejnë reformat territoriale, qoftë nga ana e kompetencave në raport me pushtetin qendror? Kjo u prek pak më përpara, por edhe nga ana territoriale. Këtë e marr, këtë pyetje e mbaj t'u marr shkast edhe prej shumë komunikimeve që kam pasur në zonë, kryesisht me zonën e Pukës, që jeni edhe në kufi. Dhe është një zonë që është zona e Xhexhanit, që sot i përket bashkisë së Pukës, dikur ka qenë e Mirëditës, por di që për këto faktorët socialë që përmenda, banorët pretendojnë që i përkasin më shumë Mirëditës sesa Pukës. Ju si e mendoni si edhe si vendas, edhe si kryetar i bashkisë së Mirëditës? Faleminderit.

Albert Melyshi:

Faleminderit shumë të dy deputetëve për pyetjet. Në fakt, janë ë po nisim nga pyetja e fundit. Më fal, deputet. Është jo vetëm Xhexhani, në fakt, edhe Fusharzi, bashkia Fusharz që është sot, deri në qafën e Malit, ka qenë pjesë e territorit të bashkisë së Mirëditës, pjesë e territorit të Mirëditës etnografike. Është shiko, dhe kjo është e lidhur pastaj edhe me pyetjen që deputeti bëri më përpara, që gjatë gjithë fjalës time, besoj, është kuptuar që ka të lidhje me financat, me financat vendore. Është nëse do zero një bashki ose një pushtet vendor, njësi e vetë qeverisjes vendore, nëse aq financa sa sot ka bashkia e Mirëditës, nuk i mjafton, qoftë sikur të ishte dhe të isha kryetar i bashkisë Rrëshenë të dikurshme. Por nëse, nëse financat vendore do shtoheshin në raport edhe me, me territorin, e njëkohësisht ato që fola më përpara, qoftë për shtimin e kompetencave, qoftë me, me burimet natyrore që vetë Mirëdita ose Mirëditës i vjelin sot, qoftë me miniera, me hidrocentrale, me hedhëse

të energjisë elektrike, apo të tjera resurse që Mirëdita prodhon sot, por nuk i prodhon për vete. Pra, prodhon, po i prodhon për qeverinë, apo prodhon edhe për kompanitë të cilat operojnë aty. Nëse do kishte një ndarje proporcionale të drejtë të asaj që i merret me atë që i kthehet, jam i bindur që territori, qoftë edhe ai etnografik, do mund të administrohej nga bashkia me këto të ardhura të cilat mbledh. Dhe kjo pastaj, po të themi që vetë Fusharzi, apo e gjithë zona përreth Fusharzit, Xhexhanit e tjera, është e mbushur sot me kompani të cilat, po njësoj si unë, jam i bindur që kryetari i Fusharzit do flasë, me miniera dhe me resurse që po dalin nga ato zona dhe që fatkeqësisht nuk kanë një kontroll si duhet të tyre për t'u kthyer në burim. Dhe pra, në të gjithë këto komponentë, nëse do mbledheshin së bashku dhe për t'i shtuar kompetencat pushtetit vendor, bashkë me financat, territori është lehtësisht i menaxhueshëm. Nëse këto territore i jepen sot bashkisë së Mirëditës, po pa të ardhura, thjesht i shton hallet dhe asgjë më tepër. Nuk, nuk jep zgjidhje. Thjesht mund të bësh disa, mund të japësh një, një po themi kënaqësi, kënaqësi njerëzve që janë në një territor të përbashkët, ashtu siç kanë qenë më përpara, por që në fakt i bindur që do ju mungonin shërbimet, të cilat ndoshta dhe sot shumë prej tyre mungojnë, për shkak se janë zona të thella malore dhe që një pjesë e tyre kanë mungesë në infrastrukturë rrugore. Dhe lidhja pastaj edhe me turizmin, që së bashku këto të ardhura, ato të cilat vjelin nga Mirëdita, dalin nga Mirëdita, bashkë me ato që mund të zhvillohen nëpërmjet turizmit, jam i bindur që mund të menaxhohen me burimet e saj, pa patur nevojë të kërkojë, e kërkojë vazhdimisht nga qeveria. Unë jam i bindur që po. Po duhet, duhet të menaxhohen nga vetë bashkia.

Arbjan Mazniku:

Ok, faleminderit zoti Mlyushi. E vlerësoj jashtë mase kontributin tuaj edhe zonzës Cara, padyshim gjatë ditës së sotshme. Unë mendoj që kemi pasur një diskutim konstruktiv, kemi disa gjëra, kërkesat që patëm për të na çuar informacion të detajuar. Mendoj që disa gjëra janë të rëndësishme që t'ia sqarojmë dhe qytetarëve që na ndjekin, por edhe që të mbeten në rekordet parlamentare, që së pari ngrehet një diskutim për çështje diskriminimi të mënyrës së njarjes së grantit. Të dhënat na thonë një gjë që në fakt s'është kështu. Pra, të dhënat na tregojnë që qeveria shqiptare nëpërmjet grantit i jep diku te 9400 lekë për frymë të gjitha bashkive të vendit. Pra, mesatarja për frymë e sa para dalin nga granti për bashkitë. Fjala që bie "Mirëdita" merr 20000 lekë për frymë. Merr dyfishin e asaj që është mesatarja kombëtare. Ë dhe kjo vjen si rrjedhojë e formulës së ekualizimit, e cila synon që bashkitë të cilat e kanë më të vogël kapacitetin për të ngritur të ardhurat vetat, të marrin pak më shumë para nga granti. Dhe dyfishi për frymë është një vlerë e rëndësishme. Pra, nuk merr 20% më shumë, nuk merr 30% më shumë. Merr dy herë më shumë sesa është mesatarja kombëtare. Ndërkohë që nga ana tjetër, kur flasim për të ardhurat e vetë bashkive, mesatarja kombëtare është 15000 lekë për frymë. Pra, një bashki merr rreth 15000 lekë për frymë. Ë ndërkohë, ë Mirëdita merr, mbledh, ia dalë të mbledhi 3800 lekë për frymë, rreth një të katërtën e asaj që është mesatarja kombëtare. Te grupi i bashkive të vogla, që janë me më pak se 10000 banorë, ë mesatarja e të ardhurave është diku te 7140, që do të thotë edhe brenda grupit të bashkive të vogla, ku kam hequr për arsye llogarie për veten tonë Himarën, sepse është e vogël, po ka të ardhura shumë të mëdha dhe pastaj ngatarron mesatarjen e të gjithëve. Dhe kemi lënë vetëm bashkitë e vogla pa Himarën, se ndryshe pastaj del një llogari që e prish edhe më keq situatën. Ë ato mbledhin 7140 lekë për frymë. Ndërkohë që prapë me 3841-shin jemi në një nivel që është më pak se gjysma e mesatares. Këtu nuk po merrem fare me arsyet e pse ndodh kjo, por dua të them që ne kemi nevojë dhe na ndihmon shumë nga ana juaj që të bëjmë një vlerësim nëse burimet e tjera të mundshme që mund të ketë bashkia janë nga renta minerare, si mund të funksiononte, çfarë impakti do kishte kjo nga ana e

bashkisë. E kuptoj që kjo nuk është ushtrim i thjeshtë, po teksa ne duhet të bëjmë një ushtrim në nivel kombëtar, na ndihmon shumë të kemi një ushtrim të bërë nga bashkia respektive. Dhe e mirëkuptoj sugjerimin e përgjithshëm që po t'i kishim këto, s'do kishim nevojë për më shumë para. Kjo do të vlente më shumë nëse do të kishim një vlerësim. Pra thoshim nga kjo do ishin dhe kaq, do ishin dhe kaq, do ishin dhe kaq, dhe atëherë duhet ta siguronim gjënë, sepse një vlerësim i mirëfilltë na jep një qartësi për një politikë të caktuar apo një politikë të caktuar. Sepse ë dhe këtë nuk e kam thjesht me ë bashkitë të cilat në mënyrë të rëndësishme çështjen e rendes minerare, veçanërisht ato bashki që kanë ngrejnë më shumë. Dhe më pas pyetja që ju bëra, jo pa arsye, që thotë që dëgjo sikur ta kalojmë rendin mineral 100%. Ajo që është sot, se pastaj si funksionon si s'funksionon, është shumë, është pak, duhet tarifuar bazuar në volum shitjesh apo në fitim, është ushtrim më kompleks se si takon këtij komisioni. Po sikur të themi rendin mineral, në vend që ta kalojmë 5% siç është sot, ta kalojmë 100%, a ju zgjidh juve hallet? Më resht bëni që nuk ju zgjidh hallet. Pra, jemi duke kërkuar në një strukturë nga e cila nuk e di a kemi mjaftueshëm resurse të për tërhequr. Dhe por padyshim që duhet të bëjë një debat për tatimin mbi të ardhurat personale, duhet të bëjë një debat për TVSH-në, se unë ngre edhe nga disa njerëz të opozitës. Duhet të bëjë një debat për tatimin e fitimit të kompanive të fashave të ndryshme, të vogla, të mëdha, të mesme. Pra, duhet të bëjë një debat i qëndrueshëm dhe unë besoj që kryetari i bashkive mund të thonë më shumë për çështjen mbi taksën e pronës, mbi vlerën e taksës së pronës, edhe mbi mbledhjen e taksës së pronës. Por mendoj, dhe ky është prapë koment shumë miqësor, që ky diskutimi që taksën e pronës na e mbledhi OSHE-ja, gjobat na i mbledhi policia, ne thjesht i mbledhim lekët dhe pastaj t'i harxhojmë, më duket se është pak të kërkojmë një rënë pjesë të gjësë pa kërkuar. Pra, tipikisht duhet të vijë bashkë punët. Domethënë, edhe ushtrimi me mbledhë taksën e pronës, edhe me mbledhë gjobat, ato që i ka ke funksionet, se ne kërkojmë autonomi dhe më shumë kompetenca. Edhe unë jam dakord, jam amator i madh i më shumë kompetencave. Po ndërkohë themi ne duhet të kemi kompetencën ta vejmë gjobën, po për ta mbledhë ta mbledhi policia. Ne duhet të kemi kompetencën për taksën e pronës, për ta mbledhë ta mbledhi dikush tjetër. Kjo gjëja krijon një problem. Pra, se të themi ne jemi të zotë me e shpenzu, s'kemi asnjë dyshim që të gjithë njerëzit, sado të vegjël e të mëdhenj, me shpenzu funksionin e kanë. Por me bë, me e ushtru funksionin në tërësinë e tij, përgjegjësinë për kontrollin e territorit, bashkë me vënien e gjobës, bashkë me mbledhjen e gjobës dhe bashkë me menaxhimin e tij. Përgjegjësinë për kontrollin e territorit, vendosjen e tarifës së taksës së pronës, sa është taksa e pronës, me të mbledhet taksa e pronës dhe pastaj dhe të shpenzohet taksa e pronës. Se ky mekanizëm na jep ndjesinë që e kemi ciklin e plotë të kapacitetit në bashki. Nga ana tjetër, vlerësoj shumë diskutimin e sotshëm përse i përket një elementi i cili është i rëndësishëm që ne ta vendosim gjithmonë e më shumë në element të diskutimit, që ka të bëjë me kohezionin kulturor të një territori të caktuar, sepse ka një impakt jo të vogël dhe na jep dhe ndjesinë e të kuptuarit që se si territore të caktuara menaxhohen kur kanë dhe një kohezion kulturor të përbashkët, sepse kjo e faciliton, e thjeshton shumë procesin e menaxhimit, e dakordësisë që njerëzit të kenë rregulla të përbashkëta, të kenë, të paguajnë taksa të përbashkëta, të mirëmbajnë, të paguajnë për kosto të përbashkëta. Dhe pika e fundit që besoj se vlen shumë për t'u diskutuar në vijimësi është një diskutim midis që njerëzit e prekin dhe kryetari e prekin, po preket në caqe. Midis taksave dhe tarifave. Duket si një diskutim se njerëzit i thonë pothuajse si të njëjta gjë: taksa, tarifa, taksa, tarifa. Parasupozimi është i thjeshtë: arsyeja pse ka dy fjalë të ndryshme për këto dy mekanizma, sepse njëra është i mbledhim taksat, i çojmë te buxheti dhe i shpërndajmë sipas vendimarrjes kolektive, qoftë ky parlamenti apo këshilli bashkiak, për të mirën e përbashkët. Dhe nga taksat ti i pagon si detyrim të përgjithshëm dhe shërbimi i ndahet të gjithë qytetarëve. Tarifa parasupozohet që e pagon dikush për një shërbim që merr vetëm

ai. Dhe kur ne kemi disa tarifa të caktuara, atëherë ato tarifa duhet të lidhen me koston e shërbimit që i jepet. Dhe pastaj kur fillojmë dhe themi që duam dhe para nga shteti për të mbuluar tarifat, ne duhet të fillojmë të kuptojmë që për tarifat veçanërisht, se te taksat unë jam dakord që duhet të diskutojmë shumë e shumë për logjikën e taksave të ndara. Por te tarifat duhet të fillojmë dhe të mendojmë gjithmonë të gjithë bashkë, dhe kjo s'vlen për të gjithë bashkitë. Duhet të fillojmë të mendojmë gjithmonë e më shumë që nëse shërbimi kushton 5 lekë, bashkia ja ofron qytetarëve, po duhet që qytetarët t'i paguajnë këto 5 lekë për këtë tarifë, se është tarifa që vlen për, prandaj është tarifë dhe nuk është taksë. Dhe po preket pak si temë, ndërkohë që duhet të preket në mënyrë më sistematike dhe të shkojë të afrohet, se duke mbuluar ato shërbime që janë të tarifueshme me tarifë, na jep mundësinë që ato që duhet të mbulohen me taksim, që janë të mirat publike, të mirat përbashkëta, i fokusojmë. Jo rrallëherë, besoj se shumë nga bashkitë e vendit përdorin të ardhurat që vijnë nga taksimi për të mbuluar kostot e shpenzimeve që janë të tarifueshme. Dhe kjo i lë më pak vend për të shpenzuar para për atë që duhet. Sidoqoftë, dua t'ju falënderoj të gjithëve për komentet dhe ditën. Do t'ju jap fjalën, shpresoj, shkurtimisht kryetarit, që të kalojmë me koshen, se po na presin dhe jemi me përtejme.

Luçiano Boçi:

Po, e vërtetë. Është faleminderit kryetarëve të bashkive që ishin prezent, faleminderit edhe për mendimet që ndamë së bashku, për përgjigjet ndaj pyetjeve dhe angazhimin. Të jeni të bindur që edhe unë do flas po kaq në mënyrë të sinqertë si bashkëkryetari tjetër, sepse këtë argumentin e mbledhjes së të ardhurave nuk është hera e parë që e diskutojmë, por ka një spekulim të vogël këtu, domethënë që e hedh poshtë atë sinqeritetin. Kur flasim për mbledhjet e të ardhurave në bashkitë e mëdha, e marrim në total në bashki, duke konsideruar pjesën urbane dhe rurale, ndërkohë që ka një diferencë shumë të madhe dhe vetë brenda bashkisë që kjo e ardhur nuk villet njësoj si në qendër të Kurbinit, si në një njësi administrative që është shumë larg, që mund të jetë e barabartë me një bashki që nuk i ka potencialet e një bashkie që ka biznese apo ka aktivitete të madh apo të shtuar ekonomik. Pra, s'mund të përdorim shifra të tilla që janë afër spekulimeve dhe nuk do t'i pranoja si argumenta, aq më tepër kur bashkëbisedohet me bashki që kanë probleme të tilla të karakterit dhe të zhvillimit ekonomik dhe nuk mund t'i paraqisësh ato si argumenta kundër ekzistencës së tyre. Madje këtu komisioni duhet të reflektojë dhe e di shumë mirë që nga pasojat e 2014-ës ne kemi disnivele të zhvillimit të bashkive, kemi diskriminim bashkiak dhe kjo duhet të na shqetësojë, sepse një nga objektivat kryesorë të reformës së 2014-ës ishte arritja e një zhvillimi ekonomik të afërt ndërmjet territoreve të ndryshme dhe çuditërisht sot ne kuptojmë nga goja e maxhorancës që ky zhvillim ekonomik qeka me kontrast shumë të madh, çka do të thotë qartazi që kemi një, jo dështim tani, kemi një mega dështim dhe në aspektin e zhvillimit të territorit të Shqipërisë, jo në mënyrë të barabartë, për shkak të një ndërhyrje jo efikase që ka ndërprerë natyrshëm atë zhvillimin, vazhdimësinë e zhvillimit ekonomik të rajoneve apo territoreve të caktuara. Ndërsa pjesa tjetër që u atakua këtu për çështjen e rendes, meqenëse e kemi hasur dhe do e hasim edhe në bashkitë e tjera, kërkesa e kryetarit nuk është që të marri renden dhe aleluja zgjidhi të gjitha problemet. Jo, më është një e drejtë që e kërkon pushteti lokal. Po flasim për shumë drejta dhe nuk jemi duke gjetur gurin filozofik të zgjidhjes së të gjitha problemeve me një goditje, me renden dhe u zgjidh. Jo, nuk po e parashtron ashtu kryetari i mirëditës, po e parashtron si një të drejtë që shfrytëzimi i pasurive natyrore në territorin e bashkisë duhet të ketë një refleksion ekonomik nga operatorët brenda komunitetit, sepse janë pasuritë e tyre, është fati i tyre, fati i tyre që është menaxhuar keq nga qeverisja qendrore, sepse këtë fat, për çudi, e marrin operatorë që s'kanë lidhje fare me territorin. E marrin operatorë që s'kanë lidhje fare me Shqipërinë pastaj, se mund të jenë edhe

investitorë tuaj. Normal, duhet t'i stimulojnë, të vijnë, të kryejnë investime, por ama që duhet patjetër që dhe ata t'i përgjigjen një kërkesë reale, konkrete, siç ndodh në të gjitha vendet e tjera, komuniteteve ku ato zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik, sepse vetëm kështu ne fillojmë dhe reflektojmë. Nuk mund të bëjmë dialog me kryetarët e bashkive për gjëra që komisioni duhet t'i ketë detyrë. Ne marrim pjesë në shqetësimet e tyre dhe duhet të gjejmë mekanizmat për t'i mbështetur, si nga ana financiare, ashtu dhe nga ana e ligjore, e kompetencave të qarta, e funksioneve të qarta dhe e autonomisë financiare. Këtu, meqenëse jemi në situatë të tillë që pasoja e 2014-ës paska qenë ky zhvillim joproportional i Shqipërisë, atëherë i del si detyrë kësaj reforme, këtij komisioni, që të gjejë mënyra kompensuese me qëllim që të stimulohet zhvillimi ekonomik. Nuk është se ne do e rregullojmë ekonominë e këtyre territoreve në qoftë se ne realizojmë një bashkim të bashkive, sepse matematika logjike pastaj është shumë e thjeshtë: të ardhurat në atë territor që janë vjelë pak, po pak do mbeten. A, në qoftë se do bashkia e madhe të investojë sipas teorisë suaj, por bashkia më e madhe në Shqipëri është vetë qeveria, sepse ajo merr sasinë më të madhe të taksave, ajo është dhe qeveria dhe bashkia, dhe në qoftë se do ajo, po më patjetër bën katër shkolla në Rubik, bën edhe dy kopshte, se ajo i ka fondet, bën dhe shumë investime të tjera në ato bashki që kanë nevojë, ndërsa në bashkitë e tjera që kanë mundësi për të mbledhur të ardhurat e tyre vendore, shihet me një, të themi, sy tjetër, sy jo diskriminues, por në syrin e ndërtimit të një solidariteti ndërbashkiak që u tha edhe nga kolegët tanë, u përmend këtu nga zoti Mziu, sikurse edhe nga mua, që është një nga format kryesore të mbështetjes për pushtetin lokal nga qeverisja, duke mbledhur të ardhura nga bashkitë e fuqishme, nëpërmjet këtij fondi e shpërndan tek bashkitë që kanë nevojë. Ose forma më e drejtpërdrejtë, sepse taksat dhe tarifrat, thashë, i paguajmë njësoj, por shërbimet ne i marrim ndryshe. Vetë qeveria të ketë refleksion edhe për TVSH-në dhe për taksat e tjera, që një përqindje të madhe t'ia kalojë bashkive në nivelin e Produktit të Përgjithshëm Bruto, që sot është 1%, dhe ndërkohë që kërkohet që të rritet në një nivel mesatar europian 5-6%, ose duke krijuar një model real, si Gjermania që kalon në 14%. Ose në qoftë se ju jeni për modelin tjetër nordik, për modelin suedez, atëherë një pjesë e madhe e taksave që janë sot qendrore, t'ia kalojnë bashkisë. Për mbledhjen e tyre, nuk është faji i bashkisë se gjobat i mbledh policia, apo se tarifrat, apo diçka tjetër i mbledh OSHE-ja. Jo, fare, në qoftë se ne e përcaktojmë nga ana ligjore se kush është përgjegjësi për mbledhjen, atëherë bashkia, domethënë, sigurisht do të zbatojë atë legjislacion. Në qoftë se në bazë të marrëveshjes i lihet një fee një institucioni të caktuar, se OSHE-ja nuk besoj që e mbledh pa një lloj shpërblimi atë taksë, merr fee-në e vet, atëherë kjo është një marrëdhënie ekonomike ndërmjet institucioneve, e cila duhet të ndryshojë. Po, hajde ta ndryshojmë, në favor të kujt? Në favor të bashkisë. Dhe këto janë pjesë që ne duhet të reflektojmë, jo t'ia hedhim si kundërgjendime kryetarëve të bashkisë. Kjo është puna jonë dhe duhet të jetë pjesë e parashikimit të atij rezultati që ne duam të arrijmë. Nuk duhet që patjetër ne ligjërimin ta drejtojmë drejt argumentave që ju s'duhet të ekzistoni, se kjo më shqetëson jashtë mase, sepse të gjitha argumentat që ipen nga njëri krah, majtas është gjithmonë që ju jeni të varfër, meqenëse jeni të varfër, ju duhet të zhdukeni. Ky është një koncept, domethënë, aspak i majtë njëherë, domethënë, në kuptimin ideologjik, por edhe shumë diskriminues, sepse është detyra e shtetit që të ofrojë shërbime të barabarta në të gjithë territorin, të garantojë zhvillim ekonomik të barabartë, sepse nuk është kaq e barabartë, është relativisht e barabartë në të gjithë Shqipërinë, pavarësisht ku jetojnë njerëzit, sepse duhet që ky vend të jetë i banueshëm në të gjithë hapësirën e tij. Nuk mundet ne Shqipërinë ta përqendrojmë në pesë qytete të mëdha, t'i nxisim njerëzit të migrojnë apo të emigrojnë, sepse po i rikthehem përsëri kësaj teme. Nuk është kaq e lehtë për shqiptarët të migrojnë. Si mund të migrojnë një banor i mirëditës të vijë në Tiranë, me sa do e blejë shtëpinë këtu ai me 2000 euro? Me sa do e marri me qira? Me 700 euro? Dhe si do jetojë? Çfarë pune

do bëjë? Ne njerëzit i marrim nga fatet e tyre, i rrëmbejmë fatet, i hedhim mes katër rrugëve dhe themi: "Shteti s'ka asnjë lloj përgjegjësie, qeveria s'ka asnjë lloj përgjegjësie, pushteti lokal nuk ka asnjë lloj përgjegjësie." Por, në fakt, jemi këtu për të ndarë dhe për të përcaktuar përgjegjësitë. Kështu që, duke ju falënderuar, unë jam i bindur që të gjithë shqetësimet tuaja do jenë pjesë e reflektimeve të vendimmarrjes që do ketë komisioni ynë i reformës territoriale. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit! Marrim një pesë minuta pushim përpara se të vijojmë me kryetarët e bashkisë së Korçës, të cilët janë tashmë këtu. Faleminderit! Po jo më shumë se pesë minuta, ju lutem, që të fillojmë edhe të ta vejmë në vijë.